REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 106, Datë, 02.07.2020**

**“MBI**

**MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100 të Ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*” i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”,* miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 02.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.78/5 prot, datë 29.06.2020, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.118, datë 22.07.2019, ka vendosur të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” bashkë me anekset përkatëse, të propozuara nga shoqëria “OST” sh.a.

- Drafti i “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, i paraqitur nga shoqëria “OST” sha, për miratim, është i strukturuar në njëmbëdhjetë kapituj dhe tre anekse.

- “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike“ miratohen dhe monitorohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

- Shoqëria “OST” sh.a., thekson në kërkesën e saj se, implementimi i tregut balancues është parashikuar të kalojë në dy faza:

    - Faza e parë do të jetë miratimi i këtyre rregullave
    - Faza e dytë do të jetë faza implementuese pa efekte financiare (Dry run). Gjatë kësaj faze “OST”sha, do të asistohet nga asistenca teknike e zgjedhur prej financuesit dhe parashikohet që problematikat që do evidentohen gjatë kësaj faze do të reflektohen në propozime të mundshme për ndryshime të këtyre rregullave që janë përcjellë për miratim.



Adresa: Bulevardi “Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69 590;
E-mail erealb@ere.gov.al; www.ere.gov.al.

- Përsa sa më sipër “OST” sh.a. kërkon:

    - Miratimin e draft “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, me qëllim zbatimin e periudhës së implementimit të tyre për një periudhë testi (Dry run) pa efekte financiare mbi palët.
    - Pas përfundimit të kësaj periudhe të implementimit shoqëria “OST” sha do të paraqesë në Entin Rregullator të Energjisë (ERE), për miratim “Rregullat Përfundimtare të Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

- Me anë të shkresës nr. 330 prot, datë 31.07.2019, Entit Rregullator të Energjisë (ERE) njoftoi të gjitha palët e interesit lidhur me vendimin e tij me nr. 118, datë 22.07.2019

- Në vijim të këtij njoftimi shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., nëpërmjet shkresës Ref-TR-2019-00869, datë 28.10.2019, protokolluar në ERE me nr. 630/2 prot, datë 28.10.2019, kërkoi shtyrje afati për komentet lidhur me këto rregulla, por edhe pas këtyre afateve nuk rezultoi ndonjë koment nga palët e interesit.

- Në mënyrë që të diskutohej më tej mbi disa aspekte të parashikimeve të këtyre rregullave dhe të merrej opinoni i palëve të interesit, ERE me datë 10.10.2019, zhvilloi një seancë dëgjimore me palët e interesit.

- Gjatë kësaj seance dëgjimore, rezultoi se palët ishin dakort me sa parashikuar në këto draft-rregulla duke evidentuar që rregullat do të shërbejnë në përmirësimin e praktikave dhe trajtimin e çështjeve të tregut të balancimit.

- Shoqëria “OST” sh.a., bën me dije se matja e energjisë tashmë e ofron matjen 15 minutëshe, dhe po punohet për konfigurimet në mënyrë që të bëhet edhe përllogaritja në këto frekuenca kohore sipas standarteve më të mira.

- Autoriteti i Konkurrencës (AK) me anë të shkresës 554/2, datë 23.12.2019, ka përcjellë në ERE Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.670, datë 26.12.2019, "*Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në lidhje me shqyrtimin e procedurave për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike*", me anë të të cilit i rekomandon ERE-s që gjatë procedurës së miratimit të *Rregullave të Tregut Shqiptar të Ealancimit të Energjisë Elektrike*, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, të marrë në konsideratë edhe disa rekomandime të saj.

- Me qëllim për të diskutuar në lidhje me rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës (AK), Enti Rregullator i Energjisë (ERE) me datë 06.02.2020, ka zhvilluar një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e “OST” sh.a. dhe Autoritetit të Konkurrencës (AK), në mënyrë që të qartësoheshin dhe të vlerësoheshin argumentet e “OST” sh.a., për këto rekomandime.



Adresa: Bulevardi “Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69 590;
E-mail erealb@ere.gov.al; www.ere.gov.al.

- Gjatë kësaj senace dëgjimore përfaqësuesit e “OST” sh.a., sqaruan edhe një herë sa evidentuar dhe rekomanduar nga Autoriteti i Konkurrencës (AK), për të cilat përfaqësuesi i Autoriteti i Konkurrencës (AK) u shpreh që u qartësua dhe u morën sqarimet e nevojshme. Autoriteti i Konkurrencës (AK) propozoi që në këtë rregullore, në rastet kur “OST” sh.a., rezulton me të ardhura të tepërta, këto të ardhura të shpërndahen tek klientët. Një propozim i tillë, do të binte ndesh me parimet mbi të cilat është ndërtuar kjo rregullore si dhe parashikimet ligjore në fuqi, të cilat parashikojnë se “OST” sh.a. si ofrues i shërbimit të balancimit duhet të garantojë që palët përgjegjëse për balancimin të paguajnë vetëm për disbalancat që shkaktojnë, pa gjeneruar të ardhura shtesë apo humbje për “OST” sh.a.

- Gjithashtu OST sha në këtë seancë shprehu që në ERE ka kërkuar miratim paraprak pa efekte financiare të këtyre rregullave, me qëllim zbatimi gjatë periudhës *Dry run* që do zgjasë 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit dhe një periudhë implementimi të këtyre rregullave prej 2 (dy) muajsh ndërkohë që këto peridha siç bëri me dije “OST” sh.a., do i shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së këtyre rregullave dhe për evidentimin e vështirësive në implementim.

- Draft-*Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike*, janë konsultuar edhe me USAID nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe në përgjigje të ftesës së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për opinione USAID ka përcjellë në ERE qëndrimin në lidhje me draftin e Rregullave për të cilat ERE ka filluar procedurën

- Komentet dhe rekomandimet e USAID që janë vlerësuar se përmirësojnë dispozita të këtij dokumenti janë reflektuar në të.

- Komentet e USAID të cilat japin një orientim apo propozim të përgjithshëm në lidhje me dispozitat e kësaj rregulloreje në të cilat në vlerësim të USAID duhet ndërhyrë me qëllim përmirësimin e gjuhës, përshkrimit apo propozime që nuk lidhen me objektin e këtij dokumenti, nuk janë pranuar, duke vlerësuar se kuadri ligjor rregullator ka saktësuar e sanksionuar mjaftueshëm si terminologjinë e termave teknike ashtu edhe sferën e kufizimit apo shtrirjes së të drejtave dhe detyrimeve të palëve.

- Konstatohet se “OST” sh.a., në cilësinë e draftuesit të këtyre rregullave mundet të adresojë çdo nevojë për ndryshime të këtyre rregullave në Entin Rregullator të Energjisë (ERE), në formën e kërkesës apo propozimeve për shqyrtim të ndyshimeve.

- Modeli i marrëveshjes së Ofruesit të Shërbimit të Balancimit (OSHB), modeli i marrëveshjes së Palës Përgjegjëse Balancuese (PPB), formulari i deklarimit; informacion i PPB mbi personat përgjegjës për çështje të tregtisë dhe shlyerjes; kërkesë për kontratë pala përgjegjëse për balancimin si dhe informacion i OSHB mbi personat përgjegjës për çështje të tregtisë dhe shlyerjes, janë pjesë integrale e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike.



Adresa: Bulevardi “Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69 590;
E-mail erealb@ere.gov.al; www.ere.gov.al.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”. (bashkëlidhur)
2. “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” hyjnë në fuqi pas botimit dhe do të zbatohen nga pjestarët e tregut të energjisë elektrike pa efekte financiare deri në datën 31.12.2020.
3. Brënda datës 30.11.2020, shoqëria “OST” sh.a., të përcjellë në Entin Rregullator të Energjisë (ERE), një raport vlerësimi për zbatimin e këtyre rregullave pa efekte financiare për këtë periudhë. Raporti i vlerësimit duhet të evidentojë qartë dhe me argumentat përkatëse nëse është e nevojshme rishikimi i tyre, përpara aplikimit të *Rregullave të Tregut të Balancimit* me efekte financiare.
4. Me përfundimin e periudhës së shprehur në pikën 2, “Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë Elektrike” miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr.193, datë 24.11.2017 shfuqizohen.
5. Shoqëria “OST” sh.a., të raportojë dhe dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të *Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike*.
6. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në pas botimit në Fletore Zyrtare.
Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brënda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**



Adresa: Bulevardi “Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69 590;
E-mail erealb@ere.gov.al; www.ere.gov.al.

# RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Përmbajtja

RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE....0

1 DISPOZITA TË PERGJITHSHME....4

**1.1** Qëllimi dhe objektivi....4

1.1.1 Qëllimi....4

1.1.2 Objektivi....4

**1.2** Fjalor dhe marrëveshje....4

1.2.1 Marrëveshje....4

1.2.2 Fjalor....5

2 BAZA LIGJORE....6

3 MIRATIMI DHE RISHIKIMI....6

4 FUSHËVEPRIMI....8

**4.1 Rolet dhe përgjegjësitë**....8

4.1 OST sha....8

4.1.3 PPB....12

**4.2** Detyrimet mbi të gjitha Palët e Lidhura....13

5 BALANCIMI I SISTEMIT....13

**5.1 Specifikimi i masave që duhet të merren nga OST në rastin e disbalancave në sistem**....13

**5.2** Përgjegjësia e balancimit....14

5.2.1 Përkufizime....14

5.2.2 Njohja si PPB....15

5.2.3 Regjistri i Palëve Përgjegjëse Balancuese....15

**5.3** Procesi i Nominimeve të Energjisë....17

5.3.1 Procesi i nominimit....17

**5.4** Proçesi i shkëmbimit të të dhënave të matjes....18

**5.5** Rregullat Operative në lidhje me nominimet dhe shkëmbimin e të dhënave të matjes 18

5.5.1 Rregullat në lidhje me nominimet....18

**5.6 Çmimi i disbalancave**....20

**5.7 Kërkesat e kolateralit të PPB** .......... 20
**5.7.6 Garancitë financiare ndryshojnë në varësi të llojit të PPB:** .......... 21
**5.8** Faturimi dhe shlyerja për PPB .......... 22
5.8.1 Faturimi .......... 22
5.8.2 Fatura e disbalancave .......... 23
5.8.3 Afati i pagesës .......... 23
5.8.4 Kundërshtimet .......... 23
5.8.5 Modalitetet për mbledhjen e çdo shume të papaguar .......... 24
**5.9** Procesi i ndryshimit të PPB .......... 24
5.9.1 PPB përfundon shërbimet e saj .......... 24
5.9.2 Ndryshimi i PPB-së në një pikë lidhje .......... 25
5.9.3 Mundësia e fundit e balancimit .......... 25
6 Produktet dhe perkufizimi i tyre .......... 25
**6.1** Lista e produkteve .......... 25
**6.2** Rezervat e mbajtjes së frekuencës (FCR) .......... 26
(Rezervat Primare) .......... 26
**6.3** Rezervat e rivendosjes së frekuencës të aktivizuara automatikisht (aFRR ). 27
**6.4** Rezerva e rivendosjes së frekuencës e aktivizuar manualisht (mFRR) .......... 28
**6.5** Rezerva zëvendësuese (RR) .......... 29
**6.6** Rezervat e Emergjencës (ER) .......... 30
7 PARAKUALIFIKIMI .......... 30
8 PROCESI I ANGAZHIMIT MBI DISPONUESHMËRINË DHE SHPËRNDARJEN .......... 31
9 PROCESI I AKTIVIZIMIT .......... 31
**9.1** FCR .......... 31
**9.2** aFRR .......... 31
**9.3** mFRR/RR me kohë aktivizimi ≤ 30 min. .......... 33
**9.4** Rezervat e Emergjencës .......... 34
**9.5** Rezerva Zëvendësuese me kohë aktivizimi > 30 min. .......... 34
10 FATURIMI DHE SHLYERJA PËR OSHB .......... 34
11 MENAXHIMI I KONGJESTIONEVE TË BRENDSHME .......... 35
12 ANEKSET .......... 37

**12.1** Modeli i Marrëveshjes së OShB (në një dokument të veçantë) .................... 37

**12.2** Modeli i Marrëveshjes së PPB (në një dokument të veçantë)....................... 37

**12.3** Përcaktimi i çmimeve të disbalancave ......................................................... 38

# 1 DISPOZITA TË PERGJITHSHME

## 1.1 Qëllimi dhe objektivi

### 1.1.1 Qëllimi

1.1.1.1 Qëllimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit është të:

a. themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, që operohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;
b. përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në tregun e balancimit;
c. mundësojnë përgjegjësi të qarta të balancimit për pjesëmarrësit e tregut;
d. përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit të balancimit,
e. krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokuruara nga OST si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për Palët Përgjegjëse të Balancimit; dhe
f. çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues.

### 1.1.2 Objektivi

1.1.2.1 Objektivi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit është krijimi i një mekanizmi balancues efiçient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin si dhe të ofrojnë shërbime balancuese.

## 1.2 Fjalor dhe marrëveshje

### 1.2.1 Marrëveshje

1.2.1.1 Në këto Rregulla të Tregut Shqiptar të Balancimit, me përjashtim të rastit kur citohet ndryshe:

a. numri njëjës përfshin numrin shumës dhe anasjelltas;
b. referimi për çdo gjini përfshin edhe gjininë tjetër;
c. Referimi në çdo dokument ligjor ose akt nënkupton dokumentin ligjor ose aktin siç është në fuqi sipas rastit, në përputhje me termat e tij; me kusht që referimi te Rregullat e Tregut nënkupton Rregullat e Tregut që janë në fuqi në datën kur janë miratuar këto Rregulla të TShB;
d. referimet në çdo legjislacion përfshijnë referimet për çdo amendim ose ri-miratim të këtij legjislacioni si dhe çdo legjislacion që ka zëvendësuar atë legjislacion; dhe

e. referimet në dokumentet ose aktet ligjore do të konsiderohen që i refohen të gjitha shtesave ose amendimeve të tyre.

1.2.1.2 Në këto Rregulla të Tregut Shqiptar të Balancimit:

a. Koha – do të jenë me Orën Lokale në Shqipëri.
b. Monedha – monedha e përdorur në këto Rregulla të TShB do të jetë në Euro pasi tregjet e organizuara *ex-ante* të energjisë elektrike likujdohen në këtë monedhë.
c. Njësitë – Të gjitha njësitë teknike shprehen në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI). Gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë elektrike shprehen në kWh (MWh, GWh), në mënyrë të ngjashme gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë reaktive shprehet në kVARh (MVARh). Kapaciteti ose kërkesa ose Fuqia shprehen në kW (MW).

## 1.2.2 Fjalor

| | |
|---|---|
| aFRR | Rezervat për Rivendosjen Automatike te Frekuencës |
| PPB | Pala Përgjegjëse për Balancimin |
| OShB | Ofrues i Shërbimit të Balancimit |
| Zonë Kontrolli | Zonë kontrolli LFC |
| Bllok Kontrolli | Bllok kontrolli LFC |
| NgM | Ngarkesë e menaxhueshme |
| EBGL | Udhëzuesi mbi Balancimin e Energjisë në Evropë |
| ENTSO-E | Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike |
| ERE | Enti Rregullator i Energjisë |
| FCR | Rezervat për Mbajtjen e Frekuencës |
| FRR | Rezervat për Rivendosjen e Frekuencës |
| Brenda Ditës (ID) | Brenda Ditës ose Rritës / Zbritës |
| Tregu Brenda Ditës (IDM) | Tregu Brenda Ditës |
| PShD | Periudha e Shlyerjes së Disbalancave |
| KESH | Korporata Elektroenergjitike Shqiptare |
| LFC | Rregullimi Ngarkesë-Frekuencë |
| NC LFC&R | Kodi i Kontrollit Fuqi-Frekuencë (tashmë pjesë e SOGL) |
| L.max | Ngarkesa maksimale në sistem |

| | |
|---|---|
| LRR | Rezervat e mundësisë së fundit |
| mFRR | Rezervat e Rivendosjes Manuale të Frekuencës |
| OSSh | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes |
| OST sha | Operatori i Sistemit të Transmetimit |
| BShE | Bursa e Energjisë, që organizon tregun e Ditës në Avancë dhe Brenda Ditës |
| RR | Rezervat Zëvendësuese |
| SOGL | Udhëzuesi për Operimin e Sistemit i EN N-E |

# 2 BAZA LIGJORE

2.1 Ligji për sektorin e energjisë elektrike, nr. 43/2015, i ndryshuar, përcakton "balancimin" si tërësinë e veprimeve dhe proçeseve përmes të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të paracaktuar të qëndrueshmërisë. Tregu Balancues përcaktohet si një menaxhim me bazë tregu i veprimeve për balancimin e Sistemit Elektroenergjitik, i operuar nga OST.

2.2 Rregullat TShB u hartuan si një dokument plotësues i Rregullave të Tregut, sipas Ligjit Për sektorin e Energjisë Elektrike, i cili parashikon që Rregullat e Tregut do të përfshijnë balancimin e energjisë elektrike: Neni 51 pika 1(b), Neni 51 pika 2 (c); Neni 98, neni 99 pika 2 dhe Neni 3 “Përkufizime” pika 59.

2.3 Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit bazohen mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit të të gjithë pjesëmarrësve të tregut si dhe transparencës në komunikim dhe sjelljes korrekte midis OST dhe pjesëmarrësve të tregut (përfshirë PPB dhe OShB). Në rast të ndonjë mospërputhje midis dispozitave që lidhen me balancimin, të vendosura sipas këtyre Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe Rregullave të Tregut, këto Rregulla do të mbizotërojnë.

# 3 MIRATIMI DHE RISHIKIMI

## 3.1 Miratimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

3.1.1 Sipas Nenit 98 të Ligjit Për Sektorin e Energjisë Elektrike, ERE, me propozimin e OST sha dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton Rregullat e tregut të energjisë elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, dispeçerimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës.

3.1.2 Këto Rregulla të Tregut Shqiptar të Balancimit do të konsiderohen si Treg Balancues pjesë e Rregullave të Tregut, të parashikuara në Ligjin Për Sektorin e Energjisë Elektrike, dhe si të tilla ndjekin proçesin e hartimit dhe miratimit të përshkruar më sipër.

## 3.2 Hyrja në fuqi e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

3.2.1 Rregullat TShB hyjnë në fuqi me miratimin e tyre nga Bordi i ERE-s. Duke pasur parasysh Nenin 2 të VKM nr. 519, datë 13/7/2016 për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Nenin 100 pika (3) të Ligjit nr. 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike, të ndryshuar, ERE shfuqizon edhe "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

3.2.2 ERE dhe OST do të publikojnë Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit në faqet e tyre të internetit.

## 3.3. Ndryshimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

3.3.1 Rregullat TShB mund të ndryshohen bazuar në shkaqe të argumentuara nga OST sha, ERE ose nga çdo pjesëmarrës tregu nëpërmjet një kërkese të drejtuar OST sha. OST sha do të krijojë një Komitet përgjegjës për ndryshimin e Rregullave, i cili mund të iniciojë ndryshimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe OST sha do t'i paraqesë zyrtarisht ERE-s ndryshimin e propozuar.

3.3.2 Proçesi i ndryshimit ndjek të njëjtën proçedurë si ajo e miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit: ndryshimi i propozuar paraqitet nga OST sha në ERE për miratim ose iniciohet nga ERE pas konsultimit me OST sha.

3.3.3 OST pergatit nje raport i cili do të përfshijë regjistrimin e ankesave dhe/ose vërejtjeve të pjesëmarrësve të Tregut Shqiptar të Balancimit si edhe çështjeve të identifikuara nga OST sha, të shoqëruara me veprimet korrigjuese përkatëse, nese ka. Pas konsultimit të organizuar nga ERE, mund të përgatiten ndryshimet në këto Rregulla.

## 3.4 Proçedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit (dhe në Marrëveshjet e PPB dhe OShB)

3.4.1 Në rast mosmarrëveshje, palët e përfshira në mosmarrëveshje do të përpiqen të zgjidhin atë në mirëkuptim, nëpërmjet negocimit ose ndonjë zgjidhje tjetër miqësore.

3.4.2 Në rast se mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet përmes mirëkuptimit, Pala/Palët mund të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre tek ERE në përputhje me Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e

mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, miratuar nga ERE (Vendimi i Bordit të ERE-s, nr. 114, datë 8.7.2016).

### 3.5 Procedura dhe kushtet për vendosjen e gjobave

3.5.1 ERE monitoron performancën e pjesëmarrësve të tregut ne lidhje me zbatimin e ketyre rregullave dhe mund të vendosë gjoba në përputhje me "Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vënies së gjobave" të parashikuar nga neni 107 pika 4 të Ligjit Për sektorin e Energjisë Elektrike.

### 3.6 Elemente të tjera të këtyre rregullave

3.6.1 Çështje të tjera që nuk mbulohen nga këto Rregulla të Tregut Shqiptar të Balancimit, të tilla si: Kodi i sjelljes, çështjet e konfidencialitetit dhe rregullime të tjera, do të zbatohen në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut në fuqi.

## 4 FUSHËVEPRIMI

### 4.1 Rolet dhe përgjegjësitë

### 4.1 OST sha

4.1.1.1 OST sha është Operatori i Sistemit të Transmetimit në Shqipëri, i cili është përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së sistemit. Një nga kriteret e sigurisë së sistemit është balanca e sistemit. Për ta ruajtur atë, OST sha do të jetë përgjegjëse për prokurimin e shërbimeve balancuese nga ofruesit e shërbimeve të balancimit (OShB) në mënyrë që të garantojë sigurinë operacionale.

4.1.1.2 OST sha është përgjegjëse për minimizimin e kostos së prokurimit të shërbimit të balancimit duke kontraktuar dhe aktivizuar rezervat më efiçente në kosto. Çdo vit, OST sha duhet të përcaktojë madhësinë e rezervave balancuese të nevojshme.

4.1.1.3 OST sha do të zbatojë një model të vetë-dispeçerimit për përcaktimin e skeduleve të gjenerimit dhe të konsumit.

4.1.1.4 OST sha është e detyruar te mbaje ne balance sistemin elektroenergjitik duke mos shkaktuar diferenca ne rezultatin neto me qellim garantimin e neutralitetin te saj financiar të rregulluar lidhur me shërbimet e balancimit ne perputhje me percaktimet e Metodologjise se Llogaritjes te Tarifave te Transmetimit te Energjise Elektrike.

4.1.1.5 Vëllimi i plotë i nevojshëm i rezervës balancuese sipas percaktimeve ligjore ne fuqi dhe ketyre rregullave prokurohet me bazë tregu, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

4.1.1.6. Nëse vërtetohet se OShB nuk i përmbush më kushtet e parakualifikimit, OST sha do të njoftojë OShB me letër rekomande për çështjen. Nëse brenda 15 ditëve pas marrjes së njoftimit, OShB nuk reagon mbi letrën rekomande dhe vazhdon të mbetet në papajtueshmëri me kushtet, OST sha ka të drejtën të përfundojë Marrëveshjen me OShB. Kjo nënkupton që nëse OShB dëshiron të ofrojë shërbimin, pas përfundimit së marrëveshjes, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet proçedurës së parakualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje të re me OST sha, në përputhje me kushtet përkatëse.

4.1.1.7 OST sha ka të drejtën të vlerësojë, në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së OShB, nëse OShB është apo jo në pajtueshmeri me termat dhe kushtet e përmendura në këtë Marrëveshje të OShB. Për të shmangur paqartësinë, kjo nuk përfshin të drejtën e OST për akses fizik në asetet e OShB, kjo duke mos cënuar rregulloret e tjera p.sh Kodin e Transmetimit, lidhur me aksesin në instalimet e lidhjes së OShB. Nëse vërtetohet se OShB nuk i përmbush më kushtet e Marrëveshjes së OShB, OST sha do të njoftojë OShB me letër rekomande. Brenda 15 ditësh, OShB duhet të provojë se janë ndërmarrë masat e duhura. Në të kundërt Marrëveshja e OShB do të pezullohet për 30 ditë. Pas periudhës së pezullimit, OST sha vlerëson përsëri pajtueshmërinë e OShB me kushtet. Nëse është rivendosur pajtueshmëria, pezullimi anulohet. Nëse jo, Marrëveshja me OShB përfundon. Pas përfundimit të Marrëvëshjes, nëse OShB dëshiron të ofrojë shërbimin, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet procedurës së parakualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje të re me OST, në përputhje me kushtet përkatëse.

4.1.1.8 Me hyrjen në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, OST sha do të zhvillojë një proces parakualifikimi dhe do të bëjë të disponueshme publikisht detajet e procesit të parakualifikimit.

4.1.1.9 OST sha ka të drejtën të ndërpresë testimet e Parakualifikimit në çdo kohë nëse ato rrezikojnë sigurinë e Rrjetit të Transmetimit ose të Rrjetit të Shpërndarjes. Në rast se OST sha vendos të ndërpresë Testin e Parakualifikimit, OST sha do të informojë OShB për një datë të re për Parakualifikim, pasi siguria e sistemit të jetë stabilizuar.

4.1.1.10 OST sha ka të drejtën të refuzojë Ofertat e Kapaciteteve që nuk janë në përputhje me rregullat dhe detyrimet e përcaktuara në këto Rregulla të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e OShB.

4.1.1.11 Në rast se vë re një sjellje e cila mund të cënojë Rregullat e Tregut dhe/ose konkurrencën e drejtë midis palëve, pasi është konsultuar me ERE dhe Autoritetin e Konkurences, OST sha rezervon të drejtën të përjashtojë OShB nga prokurimet e ardhshme.

### 4.1.2 Ofruesi i Shërbimeve të Balancimit

4.1.2.1 Ofruesi i Shërbimeve të Balancimit është pjesëmarrës tregu me njësitë ofruese të rezervës, e cila është në gjendje të ofrojë shërbime balancuese për OST-në.

4.1.2.2 Një OShB i mundshëm (i quajtur gjithashtu kandidat për OShB) duhet të paraqesë në OST sha një aplikim zyrtar së bashku me informacionin e kërkuar të rezervës së mundshme balancuese që ofrojnë njësitë teknike. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST sha do të **konfirmojë** nëse aplikimi është i plotë. Nëse OST gjykon se aplikimi nuk është i plotë, kandidati për OShB duhet të paraqesë informacionin shtesë të kërkuar, brenda 4 javëve nga marrja e kërkesës për informacion shtesë. Nëse kandidati për OShB nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, atëherë aplikimi do të konsiderohet i tërhequr. Brenda 3 muajve pas konfirmimit se aplikimi është i plotë, OST do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë e mundshme të ofrimit të rezervës i plotësojnë kushtet për parakualifikim.[1]

4.1.2.3 OST do të verifikojë në parakualifikimin OShB, kapacitetin e OShB për përmbushjen e kërkesave ligjore, informatike-teknike, të komunikimit, organizative dhe financiare. Një kriter i rëndësishëm në mënyrën me vetë-dispeçerim është që OShB duhet të ketë një kontratë me një PPB me njohje të plotë dhe shpërndarja e energjisë balancuese i caktohet portofolit të një PPB. Kandidati OShB duhet të kalojë një test komunikimi administrativ që përfshin të gjitha llojet e shkëmbimit të informacionit mes OShB dhe OST, duke përfshirë mesazhet për ofertim, për pranim, shkëmbimin e sinjaleve të standardizuara ndërmjet pajisjeve në rrjetin kompjuterik për të kontrolluar transferimin e të dhënave, për shlyerje dhe për të provuar qëndrueshmërinë e tij financiare.

4.1.2.4 OST do të kontrollojë mundesine e burimeve gjeneruese të OShB nëse teorikisht OShB mundet apo jo të ofrojë kapacitetin balancues për një produkt të caktuar përgjatë gjithë periudhës kontraktuese siç është deklaruar në aplikim. OShB i parakualifikuar do të marrë emërtimin OShB.

4.1.2.5 Kualifikimi i njësive të OShB ri-vlerësohet:

a. Në rast se kanë ndryshuar kushtet teknike apo të disponueshmërisë ose pajisjet;

b. Në rast se janë modernizuar pajisjet në lidhje me aktivizimin e Rezervës së Energjisë.

---

[1] Burimi: RREGULLORE E KOMISIONIT (BE) 2017/1485 për krijimin e linjave guidë mbi operimin e sistemeve të transmetimit të energjisë

Si pasojë, OShB përkatës do të nënshkruajë me OST Marrëveshjen OShB. Marrëveshja OShB përcakton të gjitha Termat dhe Kushtet ndërmjet OShB dhe OST.

4.1.2.6 Nëse vërtetohet se OShB nuk është më në pajtueshmëri me kushtet e procedurës së parakualifikimit, OST do të njoftojë OShB me letër rekomande. Nëse brenda 15 ditëve pune pas marrjes së njoftimit, OShB vazhdon të mbetet në papajtueshmëri me kushtet e parakualifikimit, Marrëveshja e OShB përfundon. Nëse pas përfundimit së Marrëveshjes, OShB dëshiron të ofrojë shërbimin, duhet të ri-aplikojë nëpërmjet Procedurës së Kualifikimit dhe të nënshkruajë një Marrëveshje OShB të re me OST për ofrimin e shërbimit.

4.1.2.7 Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, OShB dhe OST do të bien dakord për listën e njësive teknike që do të përdoren për të siguruar shërbimin e balancimit. Të gjitha njësitë teknike në listë duhet të kalojnë procesin e parakualifikimit të njësive teknike që vërteton kapacitetin e tyre për të përmbushur kërkesat teknike dhe organizative të përcaktuara nga OST. OShB-të e zgjedhura nuk lejohen të marrin pjesë në ankande pa përfunduar proçesin e parakualifikimit të njësivë teknike. Parakualifikimi i njësisë përfshin:

a. Përfundimin me sukses të Testit të Komunikimit me SCADA, dhe

b. Përfundimin me sukses të testeve të parakualifikimit (për Njësitë Teknike që përmbushin kërkesat teknike).

4.1.2.8 Vëllimi i parakualifikuar i Rezervës së Energjisë së njësisë teknike mund të jetë i barabartë e shumta me vëllimin maksimal që OShB mund të ofrojë në ankande. Rezultati për një parakualifikim të suksesshëm të njësisë është një licencë për njësinë e parakualifikuar.

4.1.2.9 Çdo OShB do të informojë OST, sa më shpejt që të jetë e mundur, për çdo ndryshim në disponueshmërinë ekzistuese të njësisë së tij teknike, të rëndësishëm për rezultatet e parakualifikimit.

4.1.2.10 Të gjitha kostot në lidhje me parakualifikimin mbulohen nga kandidati për OShB. Kjo mund të përfshijë të gjitha kostot variabël te tilla si: lëndë djegëse, organizim etj.

4.1.2.11 OShB do t'i ri-nënshtrohet testeve të parakualifikimit nëse OShB:

a. Parakualifikon njësitë e tij teknike për një Produkt të ri të Shërbimit, me kërkesa të tjera (të FCR, aFRR); ose

b. Rrit volumin për të cilin është parakualifikuar.

4.1.2.12 Para se të hyjë në ankandin për kapacitet, OShB dhe OST do të nënshkruajnë marrëveshjen kuadër të ankandit, i cili përcakton termat dhe kushtet specifike të ankandit mes OShB dhe OST.

4.1.2.13 Çdo OShB duhet t'i paraqesë OST ofertat e kapacitetit të tij balancues që ndikojnë në një ose më shumë PPB. Secili OShB që merr pjesë në ankandin për kapacitet balancues duhet të paraqesë dhe do të ketë të drejtën të përditësojë ofertat e tij për kapacitet balancues përpara kohës së mbylljes së portës së procesit të prokurimit.

4.1.2.14 Pasi OShB të fitojë ankandin për kapacitet, do të marrë një kontratë për kapacitet si OShB. Kontratat për kapacitet të OShB do të përmbajnë vlerën specifike të kapacitetit rezervë balancues në MW, periudhën e kontraktimit, çmimin e kapacitetit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e detajuara të OShB në fjalë.

4.1.2.15 Çdo OSHB me një kontratë kapaciteti duhet të ofrojë vëllimin e kontraktuar pa kosto për aktivizimin e tij. Ata duhet gjithashtu të ofrojnë vëllime shtesë përtej detyrimit të kontratës për aktivizimin e tyre pa kosto. Çdo OShB pa kontratë kapaciteti mund të ofrojë pa kosto aktivizimi.

4.1.2.16 OShB-të nuk do të transferojnë detyrimet e tyre kontraktuale ndërmjet tyre, si një strategji për të shmangur pagesat e penaliteteve.

### 4.1.3 PPB

4.1.3.1 PPB është në vetvete një pjesëmarrës tregu ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij që mban përgjegjësi për disbalancat e tij.

4.1.3.2 Të gjitha nominimet nga PPB duhet të jenë në pozicion neto zero. Para kohës së mbylljes së portës ndër-zonale të Tregut Brenda Ditës, çdo PPB mund të ndryshojë skedulet, të nevojshme për të llogaritur pozicionin e saj. PPB do të veprojë sipas nominimit për të shmangur disbalancat, që janë diferenca mes shkëmbimeve të nominuara dhe të realizuara në rrjet. Çdo PPB do të jetë financiarisht përgjegjëse për disbalancat kundrejt OST, sipas kostove qe shkakton cdo PBB. Me miratimin e OST-së, pas njoftimit me e-mail nga ana e PPB-së, veçanërisht për shkak të sigurisë së rrjetit. PPB ka të drejtë të devijojë nga skedulimet e njësisë.

4.1.3.3 PPB, në çdo kohë do të marrë të gjitha masat e mundshme në mënyrë që të veprojë sipas nominimit të tij ose për të ndihmuar në ruajtjen e balancës së sistemit nëpërmjet:

a. Pozicionit(eve) të injektimit dhe/ose të tërheqjes në Pikat e Lidhjes për të cilat PPB është përgjegjëse në përputhje me Marrëveshjet e Lidhjes respektive;

b. Pozicionit(eve) të injektimit dhe/ose tërheqjes në rrjetin(at) e shpërndarjes, përveç rrjetit të OST (d.m.th. Pikat e Lidhjes për të cilat PPB është përgjegjëse në përputhje me kontratat respektive që zbatohen në rrjetin(et) e shpërndarjes duke marrë parasysh metodën e alokimit të përdorur nga OSSh);

c. Nominimin(et) e tij të importit dhe eksportit; dhe

d. Transfertat e tij të brendëshme të nominimit(eve) të energjisë tek PPB-të e tjera brenda zonës së kontrollit të OST.

## 4.2 Detyrimet mbi të gjitha Palët e Lidhura

### 4.2.1 Detyrimi për të siguruar matje të sakta në pikën(at) e caktuar(a) të shkëmbimit me rrjetin ose për të patur një marrëveshje me palën lidhëse (OST ose OSSh) se si këto shkëmbime përcaktohen në mënyrë alternative

4.2.1.1 Palët e Lidhura janë të detyruara të sigurojnë matje të sakta në pikën(at) e caktuar(a) të shkëmbimit siç përshkruhet në Kapitullin VII të Kodit të Transmetimit (Neni 195, paragrafi 10), si dhe në Kapitullin II të Kodit të Matjes dhe Kodit të Shpërndarjes (Kapitulli 4.6.8) për përdoruesit respektivë të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.

### 4.2.2 Detyrimi për të caktuar një Palë Pergjegjëse Balacuese (ose të jetë vetë PPB)

4.2.2.1 Sipas Nenit 99 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, një Palë e Lidhur mund të mbajë vetë përgjegjësinë e balancimit ose mund ta transferojë atë tek një palë e tretë (PPB). Çdo pike lidhjeje duhet t'i caktohet një PPB, e cila mund të jetë ose vetë pala e lidhur, ose një tjetër PPB. OST mund të mbështetet në Regjistrin e Lidhjes për të identifikuar nëse një Pikë e lidhjes përfaqësohet nga një PPB. Në këtë rast, OST do të alokojë vlerat e matura në këto pika lidhje në përputhje me llogarinë e balancimit të PPB-së respektive.

4.2.2.2 PPB mund të jetë çdo person tjetër fizik ose juridik që plotëson kriteret e PPB të përcaktuara nga OST, duke përfshirë prodhuesit e energjisë elektrike, konsumatorët e mëdhenj, OShB-të, tregtarët etj.

# 5 BALANCIMI I SISTEMIT

## 5.1 Specifikimi i masave që duhet të merren nga OST në rastin e disbalancave në sistem

### 5.1.1 Parandalimi i veprimeve balancuese ndaj veprimeve balancuese nga OST-të e tjerë brenda të njëjtës zonë sinkrone (kompensimi i disbalancave)

5.1.1.1 OST duhet të koordionojë me OST-të fqinjë në mënyrë që të zbatojë një proçes të kompesimit të disbalancave me sipas nenit 145 pika 1 të SOGL dhe në përputhje me EBGL, si dhe sipas nismave të ENTSO-E. Kompensimi i disbalancave ndihmon në shmangien e akvitivizimit të njëkohëshëm të aFRR dhe/ose mFRR në drejtime të kundërta mes OST-ve të dy zonave të ndryshme LFC.

5.1.1.2 OST do të lidhë marrëveshjet e nevojshme në përputhje me nenin 141 të Kodit të Transmetimit dhe do të implementojë proceset në përputhje me nenin 158 të tij.

### 5.1.2 Masat dhe rendi në të cilin duhet të zbatohen

5.1.2.1 OST është përgjegjëse për dimensionimin, prokurimin, kontraktimin dhe aktivizimin e shërbimeve balancuese në mënyrë që të ruajë balancën e sistemit. Në rastin e disbalancës së sistemit OST ka të drejtë të aktivizojë shërbimet balancuese nga OShB e kontraktuar, deri në rivendosjen e balancës në sistem. Klasifikimi i shërbimeve balancuese përshkruhet në Kapitullin 6, ndërsa procesi i aktivizimit në Kapitullin 10 të këtyre Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit.

5.1.2.2 Pasi të jenë shteruar të gjitha ofertat, OST mund të shqyrtojë anulimin e programeve të eksportit për të reduktuar disbalancën e sistemit. OST duhet të hartojë dhe publikojë procedurën për këtë anulim duke marrë në konsideratë nominimet ndërkufitare të PPB-ve të përfshira.

5.1.2.3 Hapi tjetër përshkallëzues në masat balancuese është detyrimi i OShB- ve për të ulur ose rritur rezevën për të cilën OST ka dijeni që ata e disponojnë, por që nuk e kanë ofertuar për çfarëdo lloj arsye. Gjeneruesit në fjalë do të marrin automatikisht çmimin e disbalancës për kontributin e tyre, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së OShB.

5.1.2.4 Si masë të fundit, OST mund të aplikojeë çkyçjen e detyruar te Ngarkeses në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit.

## 5.2 Përgjegjësia e balancimit

### 5.2.1 Përkufizime

5.2.1.1 Ashtu siç përcaktohet në Nenin 17 të Udhëzuesit Evropian mbi Balancimin e Energjisë Elektrike 2017/2195 (BE), në kohë reale, çdo PPB do të përpiqet të jetë në balancë ose të ndihmojë sistemin të jetë në balancë. Për më tepër, çdo PPB duhet të jetë financiarisht përgjegjëse për disbalancat kundrejt OST lidhëse.

5.2.1.2 Përgjegjësia e balancimit nënkupton detyrimin ligjor mbi palët e lidhura për të dorëzuar skedulimet në lidhje me prodhimin, transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike, sipas kërkesave të specifikuara nga OST dhe OSSh dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat. Programet duhet të përmbajnë shkëmbimet e rrjetit të nominuara në çdo pikë lidhje dhe/ose transaksionet me të gjitha PPB-të e

tjera, të ndara sipas transaksioneve brenda një zone ofertimi dhe atyre përgjatë kufirit të një zone ofertimi.

### 5.2.2 Njohja si PPB

5.2.2.1 Ka dy lloje të njohjes së PPB: PPB me njohje të plotë dhe PPB me njohje tregtare. PPB me njohje të plotë janë ato të cilat mbajnë përgjegjësinë e balancimit në pikat e lidhjes në emër të palëve të lidhura dhe të cilat janë përgjegjëse për tregtimet me PPB-të e tjera. Një palë e përshtatshme, e cila nuk mban përgjegjësinë e balancimit për ndonjë Pikë Lidhje, gjithashtu mund të njihet si PPB me njohje të plotë.

5.2.2.2 PPB-të me njohje tregtare janë ato të cilat mbajnë vetëm përgjegjësinë e balancimit mbi transaksionet me PPB-të e tjera. Edhe pse një tregtar nuk ka një pikë lidhje, transferimi i pronësisë së energjisë fizike mund të bëhet përmes nominimit të transaksioneve të cilat do të bëhen vetëm nga një PPB.

### 5.2.3 Regjistri i Palëve Përgjegjëse Balancuese

5.2.3.1 OST është përgjegjës për regjistrimin e një PPB-je të caktuar në Regjistrin e PPB, i cili publikohet në faqen e internetit të OST ose kudo që konsiderohet e nevojshme nga ERE, dhe Marrëveshjes së PPB të nënshkruar me OST. Marrëveshja e PPB përcakton termat dhe kushtet në marrëdhëniet midis OST dhe PPB-ve.

5.2.3.2 Përgjegjësia e balancimit nuk do të jetë e tranferueshme te OST ose OSSh në mënyrë që të shmanget konflikti i interesit me përgjegjësitë e tregut. Përjashtim bën rasti kur PPB përfundon shërbimet e saj pa caktimin në kohë të një pasuesi dhe OST duhet të veprojë përkohësisht si PPB e mundësisë së fundit deri sa të caktohet pasuesi. Në këtë rast:

a. Përgjegjësia si PPB ndahet midis PPB-ve të mbetura bazuar në Termat dhe Kushtet ndërmejt OST dhe PPB (të cilat mund të jenë proporcionale me kapacitetin total të pikave të lidhjes për të cilat çdo PPB është përgjegjëse).

b. Ekzekutim i përkohshëm i PPB nga OST (deri sa të përfundojë ndarja); OST ka detyrim për informim të ERE; kostot përllogariten ne perputhje me percaktimet e Metodologjise se Llogaritjes te Tarifave te Transmetimit te Energjise Elektrike.

5.2.3.3 Me qëllim që të regjistrohet si PPB, PPB duhet të paraqesë në OST një aplikim në formën dhe në përputhje me afatet e specifikuara nga OST.

5.2.3.4 Aplikimi duhet të specifikojë:

a. Emrin e regjistruar të shoqërisë që aplikon;

b. Informacionin mbi kontaktin e personit përgjegjës për nënshkrimin e kontratës, për nominimin, për faturat;

c. Deklaratë noteriale;

d. Kapacitetin teknik të PPB, i cili mund të paraqitet në formën e një përmbledhje të transaksioneve kryesore të shoqërisë për blerje dhe shitje të enegjisë elektrike gjatë tre viteve të fundit;

e. Një listë të OST-ve dhe/ose OSSh-ve evropiane për të cilat ato ofrojnë shërbime si PPB, ose në forma të tjera të ngjashme.

5.2.3.5 Për të miratuar aplikimin, OST do të verifikojë që aplikuesi ka ekspertizën e kërkuar dhe pajisjet teknike, administrative dhe organizative të kërkuara për të ekzekutuar të drejtat e tij si PPB duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me nominimet, ofertimet dhe shlyerjen e disbalancave. Për këtë qëllim, më pas OST do të testojë pajisjet për shkëmbimin korrekt të mesazheve elektronike përkatëse. Me tej, OST do të nënshkruajë Marrëveshjen e PPB në të cilën PPB angazhohet të përmbushë detyrimet e saj lidhur me:

a. Kërkesat e kolateralit, që mund të përmbushen në formën e një garancie bankare, duke u plotësuar në mënyrë opsionale (sipas zgjedhjes së PPB) me një depozitë në OST;

b. Pagesën e çdo shume të debituar si pasojë e marrëveshjes (p.sh. shumat e shlyerjes së disbalancave)

c. Kushtet e përfundimit të marrëveshjes.

5.2.3.6 Në rastin e tërheqjes para kohe nga njohja si PPB:

a. OST do të sigurohet që arsyet për tërheqjen e parakohëshme nuk ekzistojnë më dhe nuk ka dyshim se ato do të përsëriten.

b. OST do të njoftojë njohjen si PPB dhe do ta publikojë atë në faqen e saj të internetit. Njoftimi duhet të përmbajë emrin, adresën dhe vendin e regjistrimit të PPB dhe llojin e njohjes (të plotë ose tregtare). OST do të informojë PPB përkatëse me e-mail para publikimit.

5.2.3.7 Pas njoftimit të aplikimit të suksesshëm, OST duhet të regjistrojë PPB në Regjistrin e PPB-ve.

5.2.3.8 Marrëveshja e PPB hyn në fuqi një ditë pasi është regjistruar në Regjistrin e PPB-ve. Në këtë Regjistër, OST do të regjistrojë emrat, adresat, numrat e telefonit

/faksit dhe llojin e njohjes së të gjitha PPB-ve të njohura si dhe të dhënat përkatëse mbi komunikimin kompjuterik.

5.2.3.9 OST do të informojë PPB për datën e hyrjes në Regjistrin e PPB-ve. Një PPB ka të drejtë të konsultohet me Regjistrin dhe të kërkojë korrigjimin e gabimeve në lidhje me përgjegjësinë e saj të balancimit. OST informon menjëherë të gjitha PPB dhe OSSh për çdo ndryshim në Regjistër.

5.2.3.10 Detyrimi për PPB me njohje të plotë është të mbajë përgjegjësinë e balancimit në pikat e lidhjes ashtu siç përmendet në Regjistrin e Lidhjes. Regjistri i Lidhjes është një listë e organizuar e të gjitha pikave fizike të lidhjes për secilin operator ku është bërë lidhja, d.m.th OST ose OSSh (Hartimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit të Lidhjes është një detyrim i përbashkët i OST dhe OSSh, ndërsa secili prej tyre mban përgjegjësi individualisht për përditësimin e Regjistrit me informacion në lidhje me palët me të cilat kanë lidhur Marrëveshje Lidhje). Në këtë rast, OST mund të mbështetet në Regjistrin e Lidhjes për të caktuar pikat e lidhjes për PPB e caktuar.

5.2.3.11 Njohja si PPB do të konsiderohet e përfunduar menjëherë, me përfundimin e Marrëveshjes së PPB. Në këtë rast, OST do të informojë menjëherë OSSh dhe PPB-të e tjera dhe do të reflektojë ndryshimet në Regjistrin e PPB-ve.

## 5.3 Procesi i Nominimeve të Energjisë

### 5.3.1 Procesi i nominimit

5.3.1.1 Të gjitha PPB-të janë të detyruara të dërgojnë nominimin e tyre te OST para mbylljes së portës. Nominimi përfshin të gjitha tregtimet ndër-zonale dhe brenda-zonale si dhe shkëmbimin brenda rrjetit për çdo PShD (Periudhë e Shlyerjes së Disbalancave) të ditës së transaksionit.

5.3.1.2 Informacioni i detajuar i kërkuar është specifikuar nga OST dhe dokumentohet në Specifikimin e Rregullave Operative.

5.3.1.3 PPB duhet të ndjekë procesin e nominimit dhe mbylljen e portës përkatëse, të cilat përcaktohen nga OST dhe përshkruhen në Specifikimin e Rregullave Operative.

5.3.1.4 OST duhet të kontrollojë nominimet e PPB-ve sa i përket konsistencës së tyre. Përkufizimi i konsistencës jepet në Specifikimin e Rregullave Operative. Nëse jepet konsistenca e nominimit, PPB do të marrë një miratim nga OST për nominimet e saj ndër-zonale dhe brenda-zonale.

5.3.1.5 Në rast se sistemi i mesazheve elektronike me anë të kutisë qendrore të postës nuk funksionon ose PPB nuk ka përkohësisht akses në sistem, një procedurë

emergjence mund të lejojë PPB-të të dorëzojnë nominimet/ri-nominimet me anë të e-mailit, në një format sipas kërkesave që do të përcaktohen nga OST.

## 5.4 Proçesi i shkëmbimit të të dhënave të matjes

5.4.1 Lidhur me shkëmbimin e të dhënave në kohë reale midis sistemeve SCADA të PPB dhe OST, OST do të përcaktojë një listë të informacionit që do të shkëmbehet. Kjo listë detajohet në Specifikimin e Rregullave Operative.

## 5.5 Rregullat Operative në lidhje me nominimet dhe shkëmbimin e të dhënave të matjes

### 5.5.1 Rregullat në lidhje me nominimet

5.5.1.1 Në orën **14:00** të Ditës në Avancë (D-1), PPB duhet të njoftojë në OST Detyrimet e tij të Rezervës së Enegjisë. Në ditën D-1, PPB do të vendosë dhe informojë OST mbi kombinimin e njësive teknike që do të sigurojnë Detyrimin e Rezervës së energjisë së tij .

5.5.1.2 PPB do të përdorë *file-n* standart të nominimeve të paracaktuar nga OST. Paraqitja e tij do të bëhet përmes platformës online të dedikuar që do të instalohet nga OST dheme e-mail si një zgjidhje rezervëm, vetëm në rastet e padisponueshmerisë së platformës.

5.5.1.3 Në rastin e ndërprerjes të detyruar, PPB njofton menjëherë OST përmes e-mail-it te personat e kontaktit të Operimit në Kohe Reale dhe Personat e Kontaktit sipas marrëveshjes me PPB-në. Në këtë rast, PPB paraqet nominimin e ndryshuar për periudhën brenda ditës për njësitë e saj .

5.5.1.4 Për secilin nominim në çdo drejtim, PPB gjithashtu duhet të ofrojë, çmimet e ofertave (në €/MWh) për çdo 15 minuta, sipas specifikimeve në Kapitullin 9 të këtyre rregullave.

5.5.1.5 Pasi kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara në D-1 nga PPB tek OST dhe çdo korrigjimi të mundshëm, nominimet e rezervave të marra do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për koherencën ndërmjet kontratave të tjera të shërbimeve ndihmëse të lidhura ndërmjet OST dhe PPB dhe korrigjohen, sipas rastit. Shpeshtësia e këtyre nominimeve është 15 minuta. Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 45 minuta para fillimit të 15 minutave të para të përfshira në përditësim.

5.5.1.6 PPB duhet të provojë aftësinë e saj për të dërguar dhe marrë të gjitha mesazhet elektronike të përcaktuara për proceset e ndryshme të punës. Kjo është pjesë e procesit të regjistrimit të PPB-ve. PPB i mohohet regjistrimi (dhe kontrata e mëvonshme) nëse nuk përfundon me sukses testimin e dërgimit të mesazheve.

5.5.1.7 OST dhe OSSh kanë detyrimin të specifikojnë:

a. Rregullat lidhur me specifikimet e mesazhit për shkëmbimin elektronik të të dhënave,

b. Procedurat dhe specifikimet për përdorimin e një sistemi qendror për shkëmbimin e mesazheve elektronike;

c. Protokollet e komunikimit për shkëmbimin e përditshëm të informacionit;

d. Specifikimet për mesazhet e nominimit dhe të gjitha mesazhet që kanë lidhje me të.

5.5.1.8 OST është **administratori ekskluziv** i sistemit qendror të mesazheve.

Kërkesat mbi përdoruesin e sistemit qendror të mesazheve duhet të jenë të certifikuara nga OST për shkëmbimet elektronike të të dhënave nëpërmjet këtij sistemi.

5.5.1.9 Procedura në rast se përdoruesi shkëmben mesazhe pa certifikatën e kërkuar është:

a. OST do të dërgojë një paralajmërim që tregon se mesazhi u injorua për shkak të certifikatës së gabuar, duke bërë me dije se paralajmërimi është regjistruar në OST si dhe duke përmendur në fund rrezikun e heqjes së të drejtës pas 2 javësh, nëse përdoruesi nuk ka ridërguar një mesazh me certifikatën e saktë brenda këtyre 2 javëve.

b. paralajmërimi regjistrohet dhe ruhet në OST (mbahet si arsye për procesin e heqjes dorë nga të drejtat),

c. Nëse certifikata nuk është marrë brenda 2 javësh nga paralajmërimi i dërguar nga OST, efektivisht kjo do të thotë se nuk mund të paraqiten nominime dhe matje pasi do të konsiderohet si Heqje dorë nga të Drejtat për përdorimin e sistemit qendror të mesazheve.

### 5.5.2 Rregullat në lidhje me shkëmbimin e të dhënave të matjes

5.5.2.1 Përpara orës 10:00 të ditës pasuese të punës, Pala Përgjegjëse për Matjen mbledh vlerat e matjes për çdo Pikë Lidhje dhe i dorëzon vlerat paraprake tek OST ose OSSh ku PPB-të lidhen dhe vlerat përfundimtare të konfirmuara brenda 10 ditëve pune pas ditës së operimit.

5.5.2.2 OST dhe OSSh i kombinojnë këto vlera me PPB përgjegjëse për secilën Pikë Lidhje. OSSh përcjell informacionin e matjes për çdo PPB në OST. OSSh gjithashtu përcakton profilet standarte te ngarkeses sipas rregullores së miratuar nga ERE dhe më pas i përcjell këto profile standarte në OST.

5.5.2.3OST ka për çdo PShD dhe për çdo PPB vlerat e matura në të gjitha Pikat e Lidhjes plus profilet standarte te ngarkeses te pergatitura nga OSSH.

## 5.6 Çmimi i disbalancave

5.6.1 Kostot e prokurimit të kapacitetit rezervë, do të përllogariten ne perputhje me percaktimet e Metodologjise se Llogaritjes te Tarifave te Transmetimit te Energjise Elektrike.Të gjitha kostot e tjera të alokuara për OST për të zhvilluar, operuar dhe mirëmbajtur proceset operative që lidhen me regjistrimin e PPB, ndryshimet, dispozitat e PPB të mundësisë së fundit, si dhe kosto të ngjashme përllogariten ne perputhje me percaktimet e Metodologjise se Llogaritjes te Tarifave te Transmetimit te Energjise Elektrike . OST do te mbaje llogari te ndara per : (i) prokurimi i kapaciteteve per sherbimet ndihmese, (ii) sherbime te tjera operative te permendura ne kete nen, (iii) si dhe llogari lidhur me kostot e disbalancave te shkaktuara nga PBB si dhe shlyerjen e PBB, me qellim vertetimin e neutralitetit financiar te OST sh.a.

5.6.2 Nuk ka përjashtime as për detyrimet financiare të PPB dhe as për detyrimin e Palëve të Lidhura për të caktuar një PPB në Pikat e Lidhjes. Secila palë e lidhur dhe secila palë tregtare duhet të caktojë një PPB. Të gjithë PPB-të marrin në ditën pasuese (D + 1) një faturë disbalancash.

5.6.3 Çmimet e energjisë balancuese të OShB paguhen me te njejtin cmim i cili është i barabartë me çmimin e ofertës më të shtrenjtë të pranuar (në rast të ofertës së kapacitetit) ose të aktivizuar (në rast të ofertës për energji). Si pasojë, llogaritja e çmimit të disbalancës bazohet në çmimet e energjisë balancuese të OShB. Çmimi i disbalancës për mungesat është gjithmone më i lartë ose i barabartë me çmimin më të lartë të energjisë balancuese për aktivizimin në rritje; çmimi i disbalancës për mungesat është gjithmonë më i ulët ose i barabartë me çmimin më të ulët të energjisë balancuese për aktivizimin në rënie (poshtë).

5.6.4 OST do të publikojë çmimet e përkohshme të disbalancës në ditën pasardhëse të punës dhe çmimet përfundimtare të disbalancës si dhe vëllimet përfundimtare të disbalancës neto, do të publikohen normalisht brenda 10 ditëve pune pas ditës së operimit.

## 5.7 Kërkesat e kolateralit të PPB

5.7.1 Si kusht pezullues për lidhjen e Marrëveshjes PPB, dhe jo më vonë nga nënshkrimi i vlefshëm i saj, PPB do t'i japë OST një garanci që përputhet me kushtet për të gjithë afatin e Marrëveshjes PPB si dhe për të gjithë kohëzgjatjen e ekzekutimit të të gjitha detyrimeve financiare që rrjedhin nga pjesëmarrja e saj në tregun e balancimit të energjisë elektrike.

5.7.2 Garancia është një siguri për ekzekutimin e kërkuar dhe të përpiktë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja e PPB në tregun e balancimit të energjisë elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, pagesën për Disbalancat dhe/ose mos-konsistencat e jashtme.

5.7.3 Garancia mund të jetë në formën e një garancie bankare me kërkesën parë të lëshuar paraprakisht nga një institucion financiar ose një pagese në të holla në OST.

5.7.4 Një PPB ka të drejtë të përdorë garanci të ndryshme gjatë kohës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së PPB. Çdo garanci duhet të ketë një afat fillestar prej të paktën një viti kalendarik dhe do të rinovohet në kohë nga PPB, me qëllim që të mbajë sigurinë e kërkuar për të gjithë afatin e Marrëveshjes së PPB dhe për të gjithë kohëzgjatjen e ekzekutimit të të gjitha detyrimeve financiare që rrjedhin nga Marrëveshja.

5.7.5 Në fund dhe/ose në përfundimin e Marrëveshjes së PPB për çfarëdo arsye, OST do ta kthejë garancinë te PPB me kusht që PPB të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e saj që rrjedhin nga Marrëveshja.

### 5.7.6 Garancitë financiare ndryshojnë në varësi të llojit të PPB:

5.7.6.1 Për PPB-të me njohje tregtare:

a. Madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga vëllimi në MWh i transaksionit neto më të lartë të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike;

b. Për fillimin e zbatimit të këtyre Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga vëllimi i transaksionit neto më i lartë të pritshëm të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike, me një minimum prej 50 MWh;

c. Shuma e kolateralit të kërkuar është e barabartë me dyfishin e madhësisë së përmendur në pikën a), ose respektivisht b) e shumëzuar me çmimin mesatar të tregut të energjisë së ditës në avancë, gjatë 3 muajve përpara përcaktimit të kolateralit;

d. Në rast se vëllimi i transaksionit neto më të lartë tejkalon më tepër se shumën në të cilën është bazuar kolaterali, me kërkesën e OST, PPB do të rrisë kolateralin e saj, ku kolaterali i ri bazohet në vëllimin e transaksionit neto më të lartë gjatë një dite kalendarike, të vërejtur gjatë 6 javëve paraardhëse pa ndërprerje. Në rast se vëllimi i transaksionit neto më i lartë është thelbësisht më i ulët se shuma mbi të cilën bazohet kolaterali, me kërkesën e PPB, OST do të lejojë një shumë kolaterali më të ulët, ku kolaterali i ri bazohet në vëllimin e transaksionit neto më të lartë gjatë një dite kalendarike, vërejtur gjatë 6 javëve paraardhëse pa ndërprerje.

5.7.6.2 Për PPB me njohje të plotë

a. Madhësia e kolateralit për një PPB përftohet nga:

i. Vëllimi në MWh i transaksionit neto më të lartë të asaj PPB me çdo PPB tjetër gjatë një dite kalendarike (për herë të parë bazohet në vlerat e pritshme me një minimum prej 50 MWh).

ii. Kapaciteti total i transmetimit në pikat e lidhjes për të cilat ai mban përgjegjësinë e balancimit

b. Shuma e kolateralit të kërkuar është e barabartë me dyfishin e madhësisë së përmendur në a. i), shumëzuar me çmimin mesatar të tregut të energjisë elektrike gjatë 3 muajve para përcaktimit të kolateralit. Kjo është shuma kolaterale A.

c. Kapaciteti i transmetimit siç është përmendur në pikën a) ii) përcaktohet nga:

i. Numri i lidhjeve në nivelin 2-10 MW shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel.

ii. Numri i lidhjeve në nivelin 11-25 MW shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel

iii. Numri i lidhjeve në nivelin 26-50 MW shumëzuar me kapacitetin më të ulët që shfaqet në atë nivel

iv. Kapaciteti total i lidhjeve > 50 MW, ku përdoren kapacitetet individuale të lidhjes

d. Kapaciteti total i transmetimit i përcaktuar në këtë mënyrë shumëzohet me 24, ku përfundimi, nëse është më i vogël se 50 MW rritet në 50 MW, pastaj shumëzohet me çmimin mesatar të tregut gjatë tre muajve para përcaktimit të kolateralit. Kjo është shuma kolaterale B.

e. Kolaterali që duhet ti vendosët PPB përcaktohet më poshtë:

i. Nëse (2 * A)> B, shuma e kolateralit që do t'i vendoset është 2 * A

ii. Nëse (2 * A) <= B, shuma e kolateralit që do t'i vendoset është A + B

f. Për rregullimin e kërkesave për kolateral, veprohet në të njëjtën mënyrë si me PPB me njohje tregtare (shih paragrafin e mësipërm d) dhe e))

## 5.8 Faturimi dhe shlyerja për PPB

### 5.8.1 Faturimi

5.8.1.1 Çdo njoftim pagese i dërguar nga OST te PPB do të përfaqësojë një pagesë të përkohshme, në varësi të zbritjes së një llogarie. Kjo zbritje realizohet në ditën

pasuese të punës, në formën e një fature ose të një njoftimi pagese dhe ndërkohë merr parasysh korrigjimet dhe informacionet e dërguara ndërkohë në OST.

### 5.8.2 Fatura e disbalancave

5.8.2.1 OST do të përcaktojë një llogari fillestare të Disbalancave të PPB për çdo 15 minuta, në ditën pasuese të punës, pasi OST të ketë mbledhur të gjitha nominimet e miratuara për tërheqje dhe injektim për çdo pikë lidhje, për transaksionet e brendshme me PPB të tjera dhe për transaksionet ndër-zonale për çdo kufi zone.

5.8.2.2 Rregullimi lidhet me llogarinë përfundimtare dhe është i mundur vetëm pasi të dhënat e tërheqjes, injektimit, transaksionet ndër dhe brenda zonale dhe të dhënat e aktivizimit të shërbimeve ndihmëse janë përfundimtare në përputhje me proçeset e zbatuara.

5.8.2.3. Fatura dërgohet me bazë ditore.

### 5.8.3 Afati i pagesës

5.8.3.1 PPB do t'i paguajë OST faturat neto pa zbritje, brenda 7 ditëve nga marrja e faturave, marrje e cila do të konsiderohet të ketë ndodhur 3 ditë pas datës në të cilën janë dërguar.

5.8.3.2 Nëse brenda 10 ditëve nga dërgimi i faturës OST nuk merr pagesën e të gjitha ose disa prej shumave të mbuluara nga faturat, OST do të ketë të drejtën të kërkojë interesin e pagesës së vonuar pa njoftuar. Interesi duhet të paguhet nga dita e dhjetë pas datës në të cilën është dërguar fatura, deri në datën kur ajo është paguar plotësisht. Vlera referuese për interesin është interesi bazë mesatar nga Java e mëparshme e publikuar nga Banka e Shqipërisë.

5.8.3.3 OST do të dërgojë një njoftim të mospagesës te PPB ndërmjet ditës së 11 dhe 15 pas ditës së lëshimit të faturës. Monedha e përdorur për faturimin dhe shlyerjen është Euro.

5.8.3.4 OST do të ketë të drejtën e tij për kompensimin e kostove ligjore në përputhje me Kodin Civil Shqiptar dhe legjislacionin në fuqi në Shqipëri, përmes të gjitha procedurave, duke përfshirë ato para gjykatës. Përcaktimet e sipërpërmendura nuk kufizojnë të drejtat e tjera të OST në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe dispozitat në termat dhe kushtet.

### 5.8.4 Kundërshtimet

5.8.4.1 Çdo kundërshtim në lidhje me faturën, në mënyrë që të jetë i pranueshëm duhet të dërgohet nga PPB në formën e shkresës zyrtare para ditës së 10 nga dita e dërgimit të faturës. PPB do të përshkruajë arsyet për kundërshtimin e saj në mënyrë të kuptueshme dhe në aq detaje sa është e mundur.

5.8.4.2 Kundërshtimi i faturës në asnjë mënyrë nuk e çliron PPB nga detyrimi i saj për të paguar faturën.

5.8.4.3 Nëse PPB ka paguar tërësisht një faturë të kontestuar në përputhje me këtë përcaktim dhe duket qartë se kundërshtimi i formuluar në përputhje me këtë përcaktim është i justifikuar, PPB ka të drejtën të kërkojë kthimin e çdo shume të paguar të kontestuar.

### 5.8.5 Modalitetet për mbledhjen e çdo shume të papaguar

5.8.5.1 Nëse fatura nuk paguhet nga PPB brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit zyrtar për mospagesë të dërguar nga OST, i cili mendohet të ketë ndodhur 3 ditë pasi është dërguar [10 ditë në total siç referohet në paragrafin 1 të nenit 5.8.3], OST ka të ketë të drejtën të tërheqë garancinë financiare siç përcaktohet në termat dhe kushtet kontraktuale të ankandit, pa cenuar zbatimin e dispozitave të mësipërme. Masat për mbledhjen e shumave të papaguara do të zbatohen nga OST në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri.

## 5.9 Procesi i ndryshimit të PPB

### 5.9.1 PPB përfundon shërbimet e saj

5.9.1.1 Palët e Lidhura dhe Furnizuesit e përfshirë do të informohen në kohë dhe do të kenë kohë të mjaftueshme për të gjetur një PPB alternative.

5.9.1.2 Një PPB që dëshiron të përfundojë shërbimet e saj duhet të njoftojë, të paktën 30 ditë pune para hyrjes në fuqi, të gjitha Palët e Lidhura ose Furnizuesit e tyre ose të dy (në rast se lidhja është më e madhe se p.sh. 3x80A) dhe OST ose OSSh ku është lidhur, në lidhje me përfundimin e synuar të shërbimeve të saj. OST do të informohet gjithashtu edhe në rast se lidhja është në nivelin e OSSh.

5.9.1.3 OST do të reflektojë përfundimin e shërbimit të PPB në Regjistrin e PPB-ve.

5.9.1.4 Palët e Lidhura të përfshira ose Furnizuesi që përfaqëson Palët e Lidhura do të informojnë OST për PPB-në(të) e(të) cila(ët) do të marrë(in) përsipër përgjegjësinë nga PPB që përfundon shërbimet e saj.

5.9.1.5 Në rast se nuk është përcaktuar në kohë pasuesi i PPB në cilindo nga Pikat e Lidhjes në fjalë:

a. Përgjegjësia e balancimit në Pikat e Lidhjes të përfshira shpërndahet mbi PPB-të e mbetura me njohje të plotë sipas rregullave të specifikuara. Kjo mund të jetë mbi bazën e p.sh. vëllimeve historike në pikat e lidhjes për të cilat ato mbajnë përgjegjësinë e balancimit.
b. Nëse është e nevojshme, OST merr përkohësisht rolin e PPB në Pikat e Lidhjes të përfshira dhe informon Palët e Lidhura në fjalë dhe ERE sipas rastit.

### 5.9.2 Ndryshimi i PPB-së në një pikë lidhje

5.9.2.1 Brenda 5 ditëve pune para hyrjes në fuqi, një Palë e Lidhur do të informojë OST ose OSSh ku është lidhur, lidhur me një ndryshim të PPB në një ose më shumë nga Pikat e tij të Lidhjes. Ky informacion duhet të shoqërohet me një deklaratë të PPB në fjalë ku ajo pranon këtë përgjegjësi. Nëse kjo deklaratë mungon, OST ose OSSh ku ato lidhen, i mohon transferimin. Përndryshe, transferimi regjistrohet në Regjistrin e Lidhjes.

### 5.9.3 Mundësia e fundit e balancimit

5.9.3.1 Në rast se një PPB përfundon shërbimet e saj pa përcaktimin në kohë të një pasuesi, përgjegjësia e balancimit në Pikat e Lidhjes në fjalë do të ndahet mbi PPB-të e mbetura sipas Termave dhe kushteve ndërmjet OST dhe OShB-ve. Kjo ndarje mund të bazohet në numrin e total të pikave të lidhjes për çdo PPB. OST do të informojë menjëherë PPB-të përkatëse duke përfshirë kohën që u jepet para se të hyjë në fuqi rialokimi.

5.9.3.2 Në kushtet e nevojës për sigurimin e shërbimit të balancimit si mundësi e fundit, OST do të sigurojë këtë shërbim nga tregjet e balancimit.

# 6 Produktet dhe perkufizimi i tyre

## 6.1 Lista e produkteve

6.1.1 Angazhimi i burimeve për të mbajtur frekuencën e rrjetit në nivelin e pranueshëm, organizohet nëpërmjet katër produkteve balancuese të paraqitura në këtë seksion. OShB është operatori i njësive teknike që ofron cilindo nga këto tre shërbime për rregullimin e frekuencës. Një përmbledhje e shkurtër e informacionit kryesor të rëndësishëm në lidhje me secilin nga produktet paraqitet në tabelën më poshtë:

| Produkti | Dimensionimi | Vëllimi i kërkuar (indikativ) | Kapaciteti i kontraktuar me bazë | Periudha e kontraktimit | Çmimi i kapacitetit | Çmimi i energjisë balancuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| FCR | Po | 6 | Vjetore | 1 vit | *Sipas* | ska, energjia e ofruar do të shlyhet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *ofertës* | si disbalancë |
| aFRR | Po | 45 | Javore | 1 javë | *Sipas ofertës* | *Paguar me çmimin më të ulët të ofruar*<br>(aFRR+mFRR) |
| mFRR | Po | 105 | Javore | 1 javë | *Sipas ofertës* | *Paguar me çmimin më të ulët të ofruar*<br>(aFRR+mFRR) |
| Rezerva e emergjencës | Jo | N/A | Vjetore | 1 vit | *Sipas ofertës* | *Sipas ofertës* |

## 6.2 Rezervat e mbajtjes së frekuencës (FCR)

## (Rezervat Primare)

6.2.1 Rezervat e Mbajtjes së Frekuencës (FCR), të njohura gjithashtu si rezervat e rregullimit primar aktivizohen në rastet e devijimit të frekuencës. FCR janë rezervat operative të nevojshme për mbajtjen konstante të frekuencës nga devijimet nga vlera nominale, me qëllim ruajtjen e balancës së fuqisë së çastit në të gjithë sistemin sinkron të interkonektuar në Evropë. Qëllimi i aktivizimit të FCR është stabilizimi i frekuencës së sistemit sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të shmanget rritja e disbalancave dhe dalja jashtë kontrollit e sistemit.

6.2.2 Rezervat e Mbajtjes së Frekuencës (FCR) aktivizohen në të dy drejtimet, si në rritje ashtu edhe në ulje. Përkufizimi i përgjithshëm i rregullimit në rritje dhe në ulje për të gjitha produktet balancuese është si më poshtë: Nën-Frekuenca pasqyron situatën, kur injektimet janë më të ulëta se tërheqjet, në këtë mënyrë nevojitet një injektim shtesë ose tërheqje më e ulët për të balancuar sistemin. Rregullimi në ulje përdoret në rastet e mbi-frekuencës. Mbi-frekuenca nënkupton se injektimet janë më të mëdha se tërheqjet, kështu që nevojiten më pak injektime ose më shumë tërheqje.

6.2.3 Kapacitetet e kontraktuara të FCR-së aktivizohen automatikisht në mënyrë të vazhdueshme nga objektet e ofruesit të shërbimit të balancimit (OShB). Kështu, njësia teknike e ofruesit të shërbimit të balancimit (OShB) duhet të jetë e pajisur me një sistem kontrolli të frekuencës. Sistemi ka për detyrë të dedektojë automatikisht ndryshimet e frekuencës në rrjet dhe të reagojë ndaj këtyre devijimeve duke aktivizuar operimin e FCR-së. FCR duhet të jetë plotësisht e disponueshme gjatë gjithë periudhës së kontraktuar. Për devijimin maksimal të frekuencës, njësia

ofruese e FCR duhet që brenda 15 sekondave të aktivizojë gjysmën e kapacitetit të kontraktuar dhe kapacitetin e plotë brenda 30 sekondave. Pas arritjes së kapacitetit të plotë, FCR duhet të qëndrojë e aktivizuar pa-ndërprerje për të paktën 15 minuta konsekutive.

## 6.3 Rezervat e rivendosjes së frekuencës të aktivizuara automatikisht (aFRR )

(Rezervat Sekondare)

6.3.1 Qëllimi kryesor i aFRR është që të rivendosë balancën në zonën e kontrollit (bllokun e kontrollit LFC) në mënyrë të vazhdueshme dhe automatike, brenda kohës së rivendosjes së frekuencës. Gjithashtu njihet si Rezervë Sekondare. Duke vepruar kështu, aFRR në mënyrë progresive zëvendëson FCR-në e aktivizuar dhe sjell përsëri në vlerën e skeduluar shkëmbimin fizik neto në kufinjtë e bllokut të kontrollit LFC, bllokuar për reagim primar.

6.3.2 OST dimensionon me bazë vjetore volumin e kapacitetit të aFRR bazuar në metodën e formulës empirike të përcaktimit të madhësisë së aFRR. Metodologjia për dimensionimin e aFRR kryesisht merr parasysh ngarkesën e parashikuar maksimale të sistemit gjatë gjithë vitit.

6.3.3 aFRR-ja aktivizohet automatikisht në drejtimin në rritje ose në drejtimin në ulje në varësi të disbalancës së sistemit (respektivisht mungesë ose tepricë). Në rast të aktivizimit të aFRR, nga qendra dispeçer e OST transmetohet një sinjal me një tarim të përcaktuar për në qendrën dispeçer të OShB-së, sinjal i cili sjell rritjen ose uljen e fuqisë së injektuar. Procesi i aktivizimit duhet të garantojë aktivizimin e plotë të rezervës sipas tarimit të të dërguar nga OST, brenda 7.5 minutave siç përcaktohet në kërkesat e detajuara.

6.3.4 aFRR operon në qark të mbyllur, duke marrë Gabimin e Kontrollit të Rivendosjes së Frekuences (FRCE) si të dhënë në hyrje dhe vlerën e tarimit për aktivizimin e aFRR si të dhënë në dalje. FRCE është i barabartë me gabimin e zonës së kontrollit (ACE) i cili përshkruan devijimin mes fuqisë reale të shkëmbyer midis zonës përkatëse LFC me zonat fqinje LFC dhe shkëmbimit ndërkufitar të skeduluar për shkak të aktivizimit të kapacitetit të FRR të ndarë mes tyre. Aktivizimi i aFRR synon të çojë në reduktimin e FRCE drejt zeros.

6.3.5 Vlera e tarimit për aktivizimin e aFRR do të llogaritet nga një Rregullator i vetëm për Rivendosjen e Frekuencës, i operuar nga OST brenda zonës së kontrollit LFC. Neni 145 pika 4 i Udhëzuesit Evropian për Operimin e Sistemit të Transmetimit (SOGL) përcakton kërkesat e mëposhtme për rregullatorin e rivendosjes së frekuencës. Ai duhet:

a. Të jetë një pajisje kontrolli  automatike e projektuar për të reduktuar FRCE në zero;

b. Të ketë karakter proporcional-integral;

c. Të ketë një algoritëm kontrolli i cili parandalon komponenten integrale të rregullatorit që të akumulojë gabimin e kontrollit dhe mbirregullimin.

d. Të ketë funksione për modalitete operimi të jashtëzakonshme për gjendjen e alarmit dhe emergjencës.

6.3.6 aFRR duhet të jetë e kontrollueshme nga LFC-ja e OST. Për qëllime monitorimi nga të gjitha OShB-të duhet të vihen në dispozicion matjet në kohë reale të fuqisë.

6.3.7 OST duhet të sigurojë disponueshmërinë e minimumit të kapacitetit të kërkuar balancues të aFRR për çdo PShD, nëpërmjet kontratave me OShB-të për të gjitha PShD-të e një peridhe kontraktuese të përcaktuar. Në këtë mënyrë OShB-të angazhohen të ofertojnë për çdo PShD të periudhës së kontraktimit, një vëllim të ofertave për energji të aFRR të paktën të barabartë me sasinë e kapacitetit të kontraktuar të aFRR gjatë procesit të aktivizimit të saj. Palë të tjera gjithashtu mund të ofertojnë kapacitetin e tyre të mbetur në dispozicion në procesin e angazhimit të shpërndarjes së energjise balancuese të aFRR në bazë vullnetare, nëse zotërojnë njësi të parakualifikuara për ofrimin e aFRR në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga OST. Ofertat për energji balancuese nga aFRR të kontraktuara nuk kanë ndonjë prioritet mbi ofertat vullnetare të energjisë balancuese të aFRR. Rradha e aktivizimit të ofertës së aFRR përcaktohet bazuar në ofertën e çmimit të aktivizimit sipas rendit të meritës ( nga më i ulëti tek më i larti) .

6.3.8 OShB-të do të paraqesin ofertat e tyre të energjisë balancuese përmes PPB-së së tyre. Energjia e aktivizuar regjistrohet në portofolin e PPB-së së tyre respektive si një transaksion energjie midis PPB-së dhe OST.

6.3.9 OST mundet, pas një paralajmërimi të dokumentuar, të refuzojë ofertat e energjisë balancuese të aFRR nga një OShB për një periudhë të pakufizuar. Kjo mund të ndodhë kur matja operacionale e disponueshme tregon se ky OShB nuk është në gjëndje të ndjekë sinjalet e kontrollit të tarimit të aFRR, ose kur mungon sinjali i matjeve operacionale. OShB mund të krijojë një objekt rregullimi për aFRR duke specifikuar të njëjtin emër të objektit rregullues, për një ofertë në rritje dhe një për ofertë në rënie. Përkufizimi i një objekti rregullues parandalon aktivizimin dhe çaktivizimin e njëkohshëm të ofertës në rritje dhe ofertës në rënie e cila kufizon shpejtësinë totale të rregullimit të kërkuar.

## 6.4 Rezerva e rivendosjes së frekuencës e aktivizuar manualisht (mFRR)

(Rezerva Terciare, koha e aktivizimit ≤ 15 min.)

6.4.1. Rezervat e mFRR janë rezerva fuqie të cilat aktivizohen manualisht, të cilat prodhues të caktuar të energjisë dhe/ose konsumatorët e mëdhenj industriale i vënë

në dispozicion të OST. Detyra e mFRR është i njëjtë me aFRR. mFRR merr këtu një rol mbështetës për aFRR, në rast se ndodh një disbalancë serioze (e madhe dhe sistematike) jo e zakontë. Aktivizimi i mFRR preferohet në rast se është më e lirë se aktivizimi i aFRR.

6.4.2 Në lidhje me kërkesat teknike, koha e aktivizimit dhe ç'aktivizimit të kapacitetit të plotë të mFRR nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta. Ka dy tipe të mFRR:

a. Rezervë prodhimi, d.m.th. injektimi i fuqisë shtesë në rrjet;
b. Reduktim konsumi, d.m.th. reduktimi i sasisë së energjisë së tërhequr nga rrjeti nga ana e përdoruesit.

6.4.3 Një OShB që nënshkruan me OST një kontratë angazhimi për disponueshmerinë e mFRR për rezervat e prodhimit, merr përsipër:

a. T'i sigurojë OST-së gjatë gjithë periudhës së kontraktimit, angazhimin për shpërndarjen e mFRR sipas ofertës, të paktën të barabartë me sasinë e kontraktuar;

b. T'a shpërndajë produktin në përputhje me kërkesat teknike të tij brenda parametrave të ofertës për të cilën është angazhuar, sipas kërkesës së OST-së për aktivizim. mFRR duhet të ofrohet plotësisht brenda 15 minutave pasi OST e ka kërkuar atë.

c. OST mund të kërkojë vetëm aktivizimin e rezervave për të cilat është dhënë një ofertë dhe për aq kohë sa është e nevojshme.

6.4.4 Aktivizimi nga OST do të konfirmohet nga prodhuesi duke përdorur një ndërfaqe të instaluar në OST dhe në ambientet e prodhuesit.

## 6.5 Rezerva zëvendësuese (RR)

(Rezerva Terciare, koha e aktivizimit > 15 min.)

6.5.1 Rezervat Zëvendësuese (RR) janë rezerva të fuqisë aktive të disponueshme për të zëvendësuar njësitë generuese që pësojnë një ndërprerje të detyruar ose që përdoren për qëllime të menaxhimit të kongjestionit. Në sistemet me vetëdispeçerim, RR duhet të aktivizohet ekskluzivisht nga tregu për të rekuperuar daljet jashtë pune të njësive gjeneruese. Në përgjithësi kjo kërkon që mbyllja e portave të tregut Brënda Ditës (ID) të jetë sa më afër të jetë e mundur me operimin kohë reale. Në këtë kuptim, RR me kohë të aktivizimit më të gjatë se mbyllja e portës së tregut BrendaDitës nuk duhet të përdoret nga OST për balancimin e sistemit. Kjo mbetet përgjegjësi e tregut.

6.5.2 Shkaku për aktivizimin e RR nga OST duhet në këtë mënyrë të kufizohet në situatat e kongjestionit që kërkojnë menaxhim efikas dhe pro-aktiv, në çdo kohë duke filluar nga mbyllja fillestare e portës së ofertave në D-1 deri në mbylljen finale të portës së ofertave. Aktivizimi i RR bëhet manualisht njëlloj si mFRR dhe sipas përkufizimit, koha e aktivizimit të RR është më shumë se 15 minuta.

6.5.3 RR duhet të ofertohet plotësisht në fillim të Periudhës së Shlyerjes së Disbalancës kur OST e kërkon ose pas kërkesës së OST brenda kohës së plotë të aktivizimit (siç specifikohet në ofertë), cilado kërkesë është bërë e fundit.

## 6.6 Rezervat e Emergjencës (ER)

6.6.1 Rezervat e emergjencës (ER) janë një lloj i veçantë i mFRR të kontraktuara me anë të menaxhimit të Kërkesës. Rezervat e Emergjencës do të merren parasysh në rast se nuk mund të kontraktohet volumi i mjaftueshëm i mFRR nga asetet e gjenerimit, për të mbuluar kërkesat e dimensionimit dhe/ose si një mbështetje për tregun që ka dështuar ë aktivizimin në kohë të rezervave zëvendesuese për ndërprerjet. Rezerva e Emergjencës do të mbahet e ndarë nga aFRR dhe mFRR e tjera dhe do të shfrytëzohen si një lloj i "rezervës së mundësisë së fundit".

6.6.2 ER mund të kontraktohet në bazë vjetore. Kontrata për ER do të përfshijë detyrimet e kapacitetit, çmimin e kapacitetit dhe çmimin e aktivizimit. Ngjashëm me FCR, nuk ka ankand për angazhimin për shpërndarje. Pas kontraktimit vjetor, njësitë e rezervës së emergjencës kanë mundësinë të paraqesin edhe një herë një ofertë në ankandin e kapacitetit, përndryshe ata deklarojnë pa-disponueshmërinë.

6.6.3 ER nuk i nënshtrohen kërkesave të dimensionimit, por ato janë një zëvendësim për mFRR dhe për këtë arsye sasia e kontraktuar do të zvogëlojë sasinë e mFRR për tu kontraktuar.

# 7 PARAKUALIFIKIMI

7.1 Para hyrjes në tregun balancues, OShB duhet të regjistrohet dhe të marrë certifikatën e parakualifikimit të njësive specifike duke synuarn tregtimin e produkteve të veçanta të shërbimit të balancimit. Për më tepër, OShB duhet të caktojë një PPB, i cili është përgjegjës për të mbajtur të balancuar portofolin e tij të balancimit.

7.2 Si parakusht për të hyrë në ankand, OShB duhet të provojë në parakualifikim aftësinë e njësive të tij teknike për të furnizuar shërbimet balancuese në përputhje me të gjitha kërkesat organizative, komunikuese dhe teknike të përcaktuara dhe të verifikuara nga OST. Procesi i parakualifikimit, kërkesat teknike të detajuara dhe testimi për çdo produkt shërbimi balancues duhet të përcaktohen nga OST dhe të dokumentohen në Specifikimin e Rregullave Operative. OST duhet të publikojë të gjithë informacionin në lidhje me parakualifikimin.

7.3 Rezultati i parakualifikimit përcakton nëse njësitë mund të furnizojnë llojin dhe sasinë maksimale të kapacitetit që njësia mund të ofrojë për këtë produkt specifik. OShB duhet të provojë jo vetëm aftësinë e njësive teknike të saj për të garantuar disponueshmërinë e deklaruar përgjatë gjithë periudhës kontraktuese, por gjithashtu aftësinë për të dhënë përgjigjen e kërkuar kur këto njësi teknike janë aktivizuar nga OST për furnizimin e shërbimeve balancuese.

# 8 PROCESI I ANGAZHIMIT MBI DISPONUESHMËRINË DHE SHPËRNDARJEN

8.1 OST është përgjegjës për prokurimin e kapacitetit balancues në ankandet e angazhimit për disponueshmërinë dhe të mundësisë për aktivizimin dhe livrimin e energjisë balancuese te siguruar në ankandin e angazhimit.

8.2, OST si Blerës i Vetëm, duhet të zhvillojë procese të standardizuara për prokurimin e shërbimit të balancimit. Këto procese do të specifikohen nga OST dhe do të dokumentohen në Specifikimin e Rregullave Operative. Përshkrimi i proçesit të prokurimit përfshin listën e aktiviteteve që duhet të kryhen nga OST dhe OShB, si dhe specifikimi i çdo aktiviteti dhe kohën e të gjitha aktiviteteve. Të gjithë këto informacione gjithashtu specifikohen në Specifikimin e Rregullave Operative.

8.3 OST duhet të publikojë në faqen e saj të internetit informacionin në lidhje me procesin e prokurimit dhe rezultatet e secilit ankand.

# 9 PROCESI I AKTIVIZIMIT

## 9.1 FCR

9.1.1 FCR aktivizohet vazhdimisht duke reaguar ndaj devijimeve të vrojtuara të frekuencës së matur me frekuencën nominale. Niveli standard i frekuencës është 50Hz, por frekuenca mundet të devijojë pak nga kjo vlerë për të korrigjuar devijimet e agreguara të frekuencës gjatë kohës (frequency time deviation). OST duhet të informojë OShB-të ofrues të FCR-së për çdo ndryshim të frekuencës së synuar, në mënyrë që ata të mund të tarojnë kontrollorët e tyre primarë, sipas rastit.

9.1.2 Pas reagimit fillestar, i cili është një veprim i përbashkët i të gjithë ofrueseve të FCR-së në të gjithë sistemin sinkron, frekuenca duhet të kthehet në vleren nominale.

## 9.2 aFRR

9.2.1 Si një hap tjetër në kontrollin e frekuencës, blloku i kontrollit LFC që shkakton devijimin e frekuencës duhet të rivendosë pozicionin e tij neto (= shuma e flukseve në import minus flukset në eksport, të korrigjuara për rregullimin primar) në pozicionin neto të skeduluar (= shuma importeve te skeduluara minus shumën e

eksporteve të skeduluara). Balancimi ndërmjet këtyre dy vlerave ështe balanca e sistemit. Kjo balancë duhet të rivendoset brenda kohës për Rivendosjen e Frekuencës, e cila në sistemin sinkron të Evropes Kontinetale është përcaktuar 15 minuta. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një procesi të koordinuar dhe centralizuar nga OST: me anë të aktivizimit automatik të aFRR nëpërmjet sistemit LFC në kombinim me aktivizimin manual të mFRR me anë të mesazheve elektronike.

9.2.2 OST do të përpiqet të minimizojë kostot totale të aktivizimit të rezervave, për të rivendosur balancën e sistemit. Prandaj duhet të marrë vendimet e mëposhtme:

a. Sa nga ofertat e ofruara për FRR do të përdoren për aktivizimin automatik të LFC?

b. Në çfarë kushtesh duhet rritur aFRR në LFC ose kur duhet aktivizuar mFRR në vend të saj?

Procedura konkrete përcaktohet si më poshtë:

a. **Procesi i nominimit**, duke dhënë për përzgjedhje dhe aktivizim ofertat e aFRR të vendosura si më të lirat, të paktën deri në vëllimin e kërkuar të LFC. Ky nominim bëhet për çdo PShD menjëherë pas mbylljes së portës për ofertim. OShB-të e përfshira informohen se ofertat e tyre janë nominuar për rregullimin LFC. Në rast se do të përzgjidhen dhe aktivizohen të gjitha ofertat e nominuara/pranuara, dhe pritet që disbalanca do të vazhdojë, ka dy mundësi nga të cilat operatori duhet të zgjedhë më optimalen, duke marrë parasysh vëllimin e aktivizuar, kohëzgjatjen e pritshme të disbalancës, cilësinë e kërkuar të kontrollit të balancës dhe kostot respektive:

   i. Nominohen dhe shtohen në LFC më shumë oferta për aFRR ; ose

   ii. Aktivizohen ofertat e mFRR (me çmim oferte sipas *rendit të meritës*) me qëllim që të zëvendësohet aFRR e aktivizuar

Parimisht, nëse ofertat e mFRR janë më të lira dhe ekziston mundësia që kjo disbalancë të vazhdojë për PShD aktuale dhe atë në vijim, mundësia (ii) do të preferohet krahasuar me mundësinë (i),

b. **Procesi i përzgjedhjes**, ky është një algoritëm automatik brenda LFC që përzgjedh nga ofertat e nominuara, aq oferta sa nevojiten me çmimin sipas *rendit të meritës* për t'u aktivizuar në paralel me qëllim që të arrihet përgjigja e kërkuar. Ky proces operon në dy drejtime: përzgjidhen më shumë oferta nëse nevojitet më shumë reagim, përzgjidhen më pak oferta nëse nevojitet më pak reagim.

c. **Procesi i aktivizimit:**

i. Të gjitha ofertat e përzgjedhura aktivizohen paralelisht (pro-rata);

ii. Ofertat që aktivizohen nga LFC në një PShD, por nuk janë më të disponueshme ose janë përzgjedhur për PShD pasardhëse, vendosen në zero duke respektuar shpejtësinë e rregullimit që ishte specifikuar. Megjithëse kjo krijon energji balancuese të aktivizuar për atë ofertë në PShD-në pasuese, oferta të tilla nuk do të ndikojnë në çmimin e aktivizimit në PShD-në pasardhëse.

iii. Kërkesa për sasinë e energjisë së aFRR monitorohet vazhdimisht nga LFC kombëtare për çdo cikël të LFC dhe ky informacion regjistrohet për cdo ofertë dhe për çdo 5 min për qëllime të shlyerjes. Çdo OShB (ose PPB-ja e tij) gjithashtu pritet të regjistrojë energjinë e aktivizuar nga OST me qëllim lehtësimin e kontrollit në informacionin e shkëmbyer.

9.2.3 Një sasi standarde e aFRR së ofruar nominohet me Cmim sipas *rendit të meritës*, të barabartë me kërkesat e dimensionimit, për secilën PShD. Kjo është e mjaftueshme për të rregulluar gabimet në disbalancë.

9.2.4 Përveç kësaj, mund të nominohen gjithashtu ofertat për aFRR deri në 100% të vellimit kërkesës së dimensionuar për mFRR, deri sa ofertat e nominuara të aFRR bëhen më të shtrenjta se oferta më e lirë e mFRR.

9.2.5 Kriteri i përzgjedhjes për përzgjedhjen e ofertave nga LFC është shpejtësia e disponueshme (ramp) e rregullimit nga ofertat e përzgjedhura kundrejt shpejtësisë së kërkuar të rregullimit siç kërkohet nga LFC. Nëse kjo është më e lartë, ofertat përzgjidhen në drejtim të kundërt sipas *rendit të meritës* së çmimit. Nëse kjo është më e ulët, ofertat përzgjidhen sipas *rendit të meritës s*ë çmimit.

9.2.6 Kur gjatë një periudhe të caktuar kohore janë aktivizuar ofertat në LFC që janë më të shtrenjta se oferta tjetër e disponueshme në rangun e ofertës së mFRR, nëse operatori i sistemit gjykon që rreziku i mbi- aktivizimit është minimal, aktivizohet oferta e mFRR.

Shihni specifikimet e **procesit të nominimit** në Specifikimin e Rregullave Operative.

## 9.3 mFRR/RR me kohë aktivizimi ≤ 30 min.

9.3.1 Ofertat e mFRR përdoren për disbalanca të mëdha dhe/ose që pritet të zgjatin në kohë. Fillimisht OST zbulon humbjen në shkallë të gjerë të prodhimit ose ngarkesës nga gradienti i rritjes së disbalances e krahasueshme me madhësinë e ndërprerjes. OST gjithashtu mund të marrë informacion nga pjesëmarrësi përkatës i tregut mbi një vlerësim të shkallës në të cilën dhe kohën në të cilën, pasojat e ndërprejes priten të eleminohen nga vete pjesëmarrësi i tregut. Paralelisht,

disbalanca do të zvogelohet automatikisht nga LFC me anë të aFRR në dispozicion. Nëse aFRR-ja e mbetur në dispozicion bie poshtë një pragu të caktuar dhe pritshmëria është që incidenti te vazhdojë me gjatë se sa disa PShD, atëherë mFRR do të aktivizohet manualisht nga OST derisa aFRR e mjaftueshme të vihet në dispozicion për shkak të veprimeve korrigjuese të pjesëmarrësve të tregut. Gjithashtu çmimi i aktivizimit mund të jetë një arsye për të aktivizuar mFRR kur është më i lirë se sa aktivizimi i aFRR më gjatë. Ofertat e mFRR aktivizohen për një periudhë minimale të një PShD të plotë dhe gjithmonë në madhësinë e plotë të ofertës.

### 9.4 Rezervat e Emergjencës

9.4.1 Në rast të rezervave të emergjencës së kontraktuara, ato do të aktivizohen vetëm pas paraqitjes së një mesazhi urgjent të tregut se ekziston një rrezik në rritje i aktivizimit të rezervave të emergjencës, përveç rasteve kur sigurohen më shumë oferta të mFRR në rritje. Ky mesazh mundet tashmë të transmetohet në ditën paraardhëse, pas mbylljes së portës të ditës paraardhëse për ofertimin e rezervave nëse ofertat e aFRR dhe mFRR në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e dimensionimit.

### 9.5 Rezerva Zëvendësuese me kohë aktivizimi > 30 min.

9.5.1 Çdo ofertë për rezerva të aktivizuara manualisht me kohë aktivizimi më të madhe se 30 minuta do të kategorizohet si "oferta për qëllime të tjera". OST do të aktivizojë keto oferta vetëm për rastet e kongjestionit dhe menaxhimit të sigurisë të rrjetit. Kjo kërkon që këto oferta të kenë gjithashtu një gjeotag (*vendodhja e paraqitur elektronikisht*).

9.5.2 Nëse këto oferta janë aktivizuar, ata do të marrin për kompensimin e kostove të aktivizimit, çmimin më të lartë të ofertës dhe çmimin e energjisë balancuese, por nuk duhet të vendosin çmimin e energjisë balancuese. Kështu ata do të cilësohen si të aktivizuara për qëllime të tjera. Çdo ofertë e aktivizuar në drejtim të kundërt për të mbajtur balancën nuk do të cilësohet dhe mund të shlyhet si çdo ofertë tjetër balancuese (*paguar me çmimin më të ulët të ofruar*).

## 10 FATURIMI DHE SHLYERJA PËR OSHB

10.1 Për çdo vëllim të angazhimit mbi disponueshmërinë të dhënë, OShB do të marrë një konfirmim të kërkesë/ofertës duke deklaruar numrin e kërkesë/ofertës së blerjes dhe kompensimet për Kapacitetin Rezervë të kontraktuar (rezervimi).

10.2 Përmes një platforme të përbashkët ose mjeti tjetër të miratuar, OST do t'i ofrojë OShB pas çdo dite pasuese të punës pas ditës së operimit, një raport lidhur me të dhënat dhe monitorimin e disponueshmërisë së kapacitetit balancues dhe shpërndarjen e energjisë balancuese në ditën e mëparshme. Një raport javor

përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë përmban shumën e të gjitha kompensimeve për kapacitetet e kontraktuara dhe energjitë e aktivizuara. Pjesa e dytë përmban të gjitha reduktimet e kompensimeve të llogaritura nga OST, duke treguar gjithashtu metodën e llogaritjes dhe të gjitha të dhënat mbi të cilat bazohet llogaritja.

10.3 Nëse më pas duket se llogaritja e reduktimit të kompensimit është (janë) e (të) pasaktë, pala e parë do të informojë palën tjetër për të ndërmarrë veprime sa më shpejt që të jetë e mundur. Palët do të përpiqen pastaj të arrijnë një zgjidhje miqësore. Në mungesë të saj, do të zbatohet proçedura e paracaktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e përcaktuar në Seksionin 3.3.4.

10.4 Brenda tri ditëve pune pas përfundimit të një jave (që përfundon të dielën), OShB mbledh vlerat nga raportet ditore dhe dërgon në departamentin e shlyerjes të OST faturën *pro-forma* javore të tij për kapacitetin balancues të kontraktuar dhe energjinë balancuese të shpërndarë.

10.5 Brenda 5 ditëve pune pas marrjes së faturës *pro-forma*, OST do të pranojë ose refuzojë atë. Në përputhje me faturën *pro-forma*, fatura mund të dërgohet në Departamentin e Faturimit & Pagesave vetem pasi OST të ketë aprovuar faturën *pro-forma*.

# 11 MENAXHIMI I KONGJESTIONEVE TË BRENDSHME

11.1 OST do të ketë detyrimin që të përdorë ofertat me kohë aktivizimi më të gjatë se 30 minuta, eksluzivisht për menaxhimin e kongjestionit.

11.2 OST do të ketë të drejtën të kufizojë lirinë e transaksioneve të Palëve të Lidhura (ose PPB-të e tyre) në rast të mundësisë për përsëritje të kongjestionit (p.sh. refuzohet ndryshimi i nominimeve që përfshijnë pikat e lidhjes në zonën me kongjestion në një drejtim që rrit kongjestionin). OST duhet të informojë PPB-të e Palëve të Lidhura respektive sipas rastit.

11.3 Procedurat operative për menaxhimin e kongjestioneve të brendshme do të kryhen si më poshtë:

a. OST ose OSSh duhet të deklarojnë zonën e kongjestionit (një zonë kongjestioni që do të përcaktohet p.sh. nga grupi i kodeve EIC të pikave të lidhjes respektive). Ndryshimet e nominimeve që përfshijnë pikat e lidhjes në zonën me kongjestion në drejtimin që rrit kongjestionin do të refuzohen. Nuk lejohen më tej transaksionet jashtë zonës nëse janë arritur limitet e eksportit të zonës dhe nuk lejohen më tej transaksionet brenda zonës nese janë arritur limitet e importit të zonës. Prandaj OST do të refuzojë nominimet e transaksioneve të tilla.

b. OShB-të brenda një zone të deklaruar kongjestioni janë të detyruara të ofrojnë tek OST rezerva në rritje ose rënie për menaxhimin e kongjestionit të

brendshëm. OST mund të caktojë nivelin e pragut të kapaciteteve të njësisë teknike që bien nën këtë detyrim, p.sh. ta ulin nëse nuk janë marrë oferta të mjaftueshme.

c. OST do të aktivizojë oferta energjie kundër-balancuese jashtë zonës me kongjestion në rastin e aktivizimit të ofertave brenda zonës me kongjestion, për të menaxhuar kongjestionin e brendshëm.

11.4 Për shlyerjen e disbalancave në një zonë të deklaruar me kongjestion, OST mund të përcaktojë një regjim të ndryshëm të shlyerjes që parandalon nxitjen e stimujve të keq-qëllimshëm në mosdhënien e ofertave të aktivizuara në zonën me kongjestion, për të lehtësuar kongjestionin. OST duhet të publikojë rregullat e një regjimi të tillë si pjesë e Specifikimit të Rregullave Operative të balancimit.

# 12 ANEKSET

## 12.1 Modeli i Marrëveshjes së OShB (në një dokument të veçantë)

## 12.2 Modeli i Marrëveshjes së PPB (në një dokument të veçantë)

## 12.3 Përcaktimi i çmimeve të disbalancave

1. Përkufizime
   1.1. Rregullimi në rritje
   1.2. Rregullimi në ulje
   1.3. Çmimi për energjinë balancuese në rritje
   1.4. Çmimi për energjinë balancuese në ulje
   1.5. Komponentja nxitëse
   1.6. Gjendja e rregullimit( e sistemit)
   1.7. Delta e balancës: autorizimi për disbalancat e sistemit për tu publikuar ne kohëreale nga OST (open loop ACE)
   1.8. Çmimi mesatar: përkufizmi i çmimit të energjisë balancuese në rastin pa rregullim
2. Specifikimi i gjendjeve të rregullimit(për secilën PShD)
   2.1. Gjendja e rregullimit = 0 nuk kërkohet as rregullim në rritje dhe as në ulje
   2.2. Gjendja e rregullimit = +1: kërkohet vetëm rregullim në rritje
   2.3. Gjendja e rregullimit = -1: kërkohet vetëm rregullim në ulje
   2.4. Gjendja e rregullimit = +1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme
   2.5. Gjendja e rregullimit = -1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës

ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme

2.6. Gjendja e rregullimit = 2:kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës nuk ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme as jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.

2.7. Gjendja e rregullimit = 2: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme dhe jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.

3. Specifikimi i çmimeve të disbalancës

3.1. Cmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = -1 (tepricë në sistem)

a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje plus komponenten nxitëse.Në këtë rast PPB paguan OST.

b) Nëse disbalanca e PPB ka të beje me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

3.2. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = +1(sistemi ka mungesë)

a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.

b) Nëse disbalanca e PPB ka të beje me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

3.3. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 2 (disbalance e dyanshme e sistemit)

a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), dhe çmimi mesatar është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
b) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë) dhe çmimi mesatar është më i ulët sesa çmimi për energjinë balancuese në rënie, çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
c) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë) dhe çmimi mesatar nuk është më i lartë së sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë çmimin per energjinë balancuese ne rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
d) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë) dhe çmimi mesatar nuk është më i ulët së sa çmimi për energjinë balancuese në ulje, çmimi i disbalancës është i barabartë çmimin per energjinë balancuese ne ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

3.4. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 0 (pa rregullim)

a) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
b) Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin mesatar minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

3.5. Komponentja nxitëse

a) Vlera fillestare: €0/MWh
b) Rregullimet e komponentes nxitëse

3.5.b.1. OST do të rregullojë komponentën nxitëse në bazë të kritereve objektive sipas një procedure të përcaktuar dhe të publikuar nga OST në faqen zyrtare.

3.5.b.2. Vlera aktuale e komponentes nxitëse do te publikohet në faqen zyrtare të OST.

3.5.b.3. ERE ka të drejtën ne cdo kohe te shqyrtoje procedurën për rregullimin e komponentes nxitëse dhe nese eshte e nevojeshme i kërkonë OST ta dergoje kete procedure per tu miratuar ne ERE dhe ta përfshijë si pjese eRregullatve te Tregut Shqiptar të Balancimit.

**3.6. Neutraliteti i kostove të OST në balancim**

a) OST do të përllogarise kostot ne perputhje me percaktimet e Metodologjise se Llogaritjes te Tarifave te Transmetimit te Energjise Elektrike lidhur me rezultatet neto të shlyerjeve të:
   - 3.6.a.1. Disbalancat me PPB-të
   - 3.6.a.2. Kostot e kontraktimit dhe aktivizimit te rezervave balancuese
   - 3.6.a.3. Proceset e balancimit ndër-kufitar duke përfshirë programet e kompesimit për shkëmbimet e paqëllimshme

3.7. Kompensimi për pagesën e komponentes nxitëse

a) Në rast se disbalanca e PPB shkaktohet nga një ngjarje në rrjet ose nga ndërhyrja e OST ose OSSh, PPB merr kompensim për pagesat në lidhje me komponenten nxitëse. Shembuj të këtyre ngjarjeve janë (jo-shteruese):
   - 3.7.a.1. Shkarkimi automatik ose manual i ngarkesës nga OST ose OSSh
   - 3.7.a.2. Rritja ose ulja e detyruar e shkembimt në rrjet nga OST ose OSSh.

b) Kompensimi do te paguhet nga operatori i rrjetit ne rrjetin e te cilit ka ndodhur ngjarja.